

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

“O ju që besuat!
Ju obligohen agjërimet ashtu
siç u ishin obliguar atyre
që ishin para jush,
që të bëheni
të druajtur (ndaj Zotit)”.

Kurani Famëlartë 2:185

VËRTETËSIA Nr. 8

një hap më pranë argumentit dhe rrugës së drejtë

PËRMBAJTJA

E mira dhe e keqja | f. 38



Lidhja e muajit
me Kuranin | 4



Kërkojeni afërs

04 Editorial - Festa e Bajramit

06 Lutja për të çelur agjërimin

08 Lidhja e muajit Ramazan me Kuranin

14 Dobitë shëndetësore të agjërit

16 Agjërimi - një ndër shtyllat e Islamit

31 Lutje e Profetit Muhammed s.a.v.s. për bashkimin,
paqen dhe vlerat pozitive

32 Ramazani - shtatë dobitë e agjërit

t Ramazan
f. 8



Ramazani - shtatë dobitë
e agjërimit | f. 32



inë e Allahut | f. 56



Muslimanët mirëpresin... | f. 68

37 Lutje për të shpëtuar
nga mosagjërimi...

38 E mira dhe e keqja

52 Qëllimi i agjërimit

56 Kërkojeni
afërsinë e Allahut

62 Lajmet

68 Muslimanët
mirëpresin...

72 Index in English

Kryeredaktor:
Samad Ghorri

Zv. kryeredaktor:
Shahid Ahmad Butt

Redaktorë gjuhësorë:
Besmir Yvejsi
Bekim Bici

Anëtarë:
Javaid Iqbal Nasir,
Bujar Ramaj

Grafika:
Vizatim.com

Shtypur në shtypshkronjën:
Europrinty.net
Prishtinë, maj 2016

Xhemati Musliman Ahmedia i
Shqipërisë, pranë Vodafonit, Rr.
“Pavarësia” Km. 1, Mëzez,
Kutia Postare 8176, Tiranë,
Shqipëri

Tel: +355(0)682974992;
0672168054; 0666619831;
+355(0)42391080
Fax: +355(0)42391081

E-mail:
vertetesia@gmail.com

Uebfaqja:
www.alislam.al
www.vertetesia.al



Festa e Bajramit

Natyra e njeriut kërkon të ketë festa në jetën e tij, në mënyrë që ai të lehtësojë dhimbjet, të harrojë brengat, të gëzohet dhe të mbushet me forcë për të vijuar rrugëtimin e mëtejshëm të jetës. Pra, të festuarit është njëri prej instinkteve të njeriut. Sikundër instinktet e tjera, edhe këtë instinkt njeriu shpesh e tepron duke e përdorur në një formë të çekuilibruar. Kështu

vërejmë që për shumëkënd festa mbetet një dëfrim deri në shfrenim, festë e cila i mundëson një kënaqësi të përkohshme, por bashkë me humbje materiale, i ngjitet një sërë vesesh e ligësish.

Në librin e tij të famshëm, “Filozofia e mësimëve të Islamit”, Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thekson se

askush nuk mund t'i mbarësojë më së miri instinktet e njeriut, përveç Krijuesit të tij? Edhe me këtë kriter mund të gjykohet feja që vjen prej Zotit dhe që aktualisht është në fuqi prej Tij.

Në fenë Islame, Zoti i Madhërishëm ka lënë dy festa dhe në to ka lënë urtësi të thella. Me anë të këtyre festave, që ndryshe quhen bajrame, Ai u dha mesazh njerëzve se si ata duhet ta konceptojnë festën dhe lumturinë e tyre. Bajramit të parë i paravendosi një muaj agjërimesh, në të cilat, besimtari heq dorë nga dëshirat e tij për hir të dëshirës së Zotit dhe ndien etje dhe uri për hir të dashurisë ndaj Tij. Gjithashtu, duke u mbushur me këtë forcë dashurie, përkrah nevojtarët, pra, të eturit dhe të uriturit e tjerë nga krijesat e të Dashurit. Pas këtij përjetimi, i vjen një ditë gëzimi, të cilin Zoti e ka quajtur "eid". Bajramin tjetër e lidhi me përkujtimin e sakrificës së Hazret Ibrahimit a.s. dhe të Hazret Ismailit a.s., duke i dhënë kështu përsëri mesazhin e sakrificës në rrugën e Tij. Edhe kjo sakrificë nga njëra anë e frymëzon njeriun asgjësimin e egos së vet për hir të të Dashurit, dhe nga ana tjetër, e motivon t'u shërbejë krijesave të Tij.

Muslimanët adhurojnë pesë herë në ditë, por në ditën e bajramit, pra në festën e tyre, ata falin gjashtë herë. Edhe kjo tregon që festa për ta është më shumë adhurim ndaj Zotit, më shumë afrim

me Të dhe më shumë kontakt me Të. Sa më shumë që robi i afrohet me Zotin, aq më shumë i shtohet edhe gëzimi në këto festa. Zoti na mundësoftë ta sjellim këtë shpirt në festat tona! Më lejoni ta mbyll këtë mesazh me një lutje të veçantë të Hazret Profetit Muhammed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të! Hazret Abdullah Ibni Mesudi r.a. tregon se gjatë bajrameve i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} bënte lutjen e mëposhtme:

O Allah! Të kërkojmë jetë me *takva* (druajtje ndaj Teje), vdekje të pastër, vendkthim jo poshtërues dhe jo turpërues.

O Allah! Mos na shkatërro me ndonjë aksident, mos na kap papritmas, mos na merr nxitimthi, përpara se ta përmbushim detyrën dhe testamentin tonë. O Allah! Të kërkojmë dëlirësinë, vetëmjaftueshmërinë, *takvanë*, udhëzimin, përfundimin e mirë në ahiret dhe në këtë botë dhe Të kërkojmë mbrojtje nga dyshimi, përçarja, dukja dhe vetëpëlqimi në besimin ndaj Teje. O Kontrollues i zemrave! Mos na shtrembëro zemrat, pasi na ke udhëzuar dhe na dhuro mëshirë prej Teje! Me të vërtetë Ti je Dhuruesi i madh!¹

Samad Ghori

1. *Maxhmauz-zavaid*, vëll. 6, f. 201.

Lutja për të çelur agjërimin

*Hazret Muadh Ibni Zuhre^{r.a.} tregon se
i Dërguari i Allahut^{s.a.v.s.} gjatë çeljes
së agjërimit bënte këtë lutje:*

اللَّهُمَّ لَكَ صُومْتُ وَعَلَى رِزْقِكَ أَفْكُرْتُ

*"O Allah! Për Ty agjërova dhe me
furnizimin Tënd po e çel (agjërimin)."*

Sunen Ebu Davud, Kitabus-savm, hadithi nr. 2358.

Lidhja
e muajit Ramazan
me Kuranin



Hazret Mirza Bashiruddin Mahmud Ahmed (r.a.)

Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar

Allahu i Madhërishëm, në Kuranin Famëlartë thotë:

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ

“Muaji Ramazan është ai, në të cilin ka zbritur Kurani“. (2:186)

Agjërimet, në fenë Islame, janë obliguar në vitin e dytë pas hixhretit (mërgimit) dhe Zoti i Madhërishëm zgjodhi muajin e ramazanit për to, pikërisht muajin në të cilin Kurani Famëlartë kishte filluar të zbritej. Historikisht dihet që i gjithë Kurani nuk zbriti brenda një muaji të vetëm, por u deshën 23 vite që të përfundojë zbritja e tij gjatë jetës së Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}. Për këtë arsye, një përkthim tjetër i këtij ajeti sugjerohet si në vijim: “Muaji Ramazan është ai, rreth të cilit ka zbritur Kurani”.

Sidoqoftë, që të dyja variantet janë të qarta në kuptimin se muaji Ramazan ka një lidhje të veçantë me Kuranin. Duke hedhur dritë mbi këtë temë, Hazret Kalifi i Dytë i Xhematit Musliman Ahmedia, Allahu qoftë i kënaqur me të, në një fjalim të tij të xhumasë, të cilin e kishte mbajtur më 1 shtator të vitit 1944, thotë:

“Ky është muaji Ramazan, i cili është i veçantë sepse pikërisht gjatë këtij muaji Kurani kishte filluar të zbritej dhe për shkak të kësaj lidhjeje, Allahu i Lartësuar këtë muaj e ka quajtur si muaj i agjërimi. Çfarë janë agjërimet? Gjatë agjërimi njeriu duhet të përmbysë rutinën e përditshme të jetës së tij. Shumë gjëra që janë të lejuara për të, bëhen të ndaluara gjatë këtij muaji, madje, edhe ato gjëra që i ka për zemër gjatë muajve të tjerë, gjatë muajit Ramazan ai heq dorë prej tyre e në kohë të caktuar, i bën të ndaluara për veten. Pra, gjërat e nevojshme dhe të lejuara, shndërrohen në ato të panevojshme e të ndaluara.

Një mësim që nxjerrim nga agjërimet e Ramazanit është përmbysja e rutinës së përditshme e jetës së besimtarëve, e që ndodh sa herë që atyre u vjen ndonjë mesazh prej Zotit. Duke e quajtur muajin e zbritjes së Kuranit Famëlartë si muaj të agjërimi përgjithmonë, Allahu i Lartësuar na tregoi që pas zbritjes së Fjalës së Tij, nuk mund të vazhdojë jeta e njeriut në mënyrë të zakonshme. Asnjëherë nuk ndodhi që të ketë zbritur ndonjë mesazh hyjnor në botë dhe jeta njerëzore të ketë vazhduar me të njëjtën rutinë, siç vazhdonte para zbritjes së tij. Ashtu siç gjatë muajit të agjërimi, për një kohë të caktuar, njeriu duhet të heqë dorë edhe nga gjërat e lejuara, në të njëjtën mënyrë, gjatë kohës kur vjen ndonjë profet,

besimtarët e tij detyrohen të heqin dorë nga të drejtat e tyre, pak për shkak të bojkotimit prej kundërshtarëve, por edhe për shkak të nënshtrimit ndaj sistemit të ri hyjnor. Armiqtë e profetit i bojkotojnë besimtarët e tij dhe ua dëmtojnë pasuritë e tyre të drejta, madje edhe i privojnë nga ato, madje, duke i torturuar në mënyra të ndryshme, ua ndryshojnë krejtësisht mënyrën e jetesës. Në të njëjtën mënyrë, besimtarëve të profetit u duhet të ndryshojnë jetën edhe për shkak të nënshtrimit ndaj porosive të reja që vijnë bashkë me profetin prej Zotit. Ata sakrifikojnë pasurinë e tyre, që është e drejta e tyre, për të përhapur besimin, për edukimin e shoqërisë etj. Pra, në dy mënyra, atyre u merren pasuritë: Zoti ua kërkon si taksë, ndërsa armiqtë ua marrin duke i persekutuar. Nga kjo pikëpamje, kjo periudhë për ta është si periudha e agjëtimeve. Agjërimet e Ramazanit vijnë një herë në vit, por besimtarët në kohën e profetit, thuajse gjithë jetën e kalojnë në agjëtime. Ashtu siç gjatë muajit të agjëtimeve, besimtarët heqin dorë edhe nga gjërat e lejuara, në të njëjtën mënyrë, besimtarët e kohës së profetit heqin dorë nga nevojat e tyre të drejta, nga dëshirat e tyre të drejta: herë për hir të besimit, e herë për shkak të persekutimeve që u bëhen nga armiqtë.

Kur punët vështirësohen, ne përdorim shprehjen “na lanë pa gjumë”. Gjumi ndalohet edhe gjatë agjëtimeve. Disa

njerëz ngrihen herët për të përgatitur syfy, e disa të tjerë ngrihen për të falur namazin e tahaxhudit. Në të njëjtën mënyrë, gjatë kohës së ardhjes së një profeti, besimtarët e tij mbeten pa gjumë për shkak të vështirësive të ndryshme që u bien. Edhe në këtë aspekt, gjithë jeta e tyre është sikur të jetë në agjërim.

Gjatë Ramazanit rëndësi e veçantë u jepet lutjeve dhe namazit të tahaxhudit. Në të njëjtën mënyrë, edhe gjatë kohës së një profeti, xhematit të besimtarëve i duhet të kalojnë jetën duke u lutur, sepse përgjegjësia me të cilën ata ngarkohen, mbetet përtej fuqisë së tyre. Nuk ka popull të ndonjë profeti, i cili të ketë dalë fitues me forcën e vet. Çdo herë kur vjen ndonjë profet, fitorja i vjen përmes lutjeve dhe përgjërimeve. E nëse xhemati i tij e kupton ashtu siç duhet detyrën e tij dhe qëllimin e ardhjes së profetit, atëherë padyshim atyre u bëhet i ndaluar gjumi i natës. Ata vazhdimisht çohen për të falur tahaxhudin, luten, përgjërohen dhe qajnë para Zotit që Ai t’ua mbulojë gabimet dhe t’ua dhurojë suksesin përmes bekimit të Tij. Nëse ndonjë popull nuk vepron në këtë mënyrë dhe kujton se vetëm duke kontribuar para, ose vetëm përmes forcës së tyre, pa bërë lutje e përgjërime gjatë netëve në tahaxhud e në namazet e tjera, atëherë ai popull duhet të jetë më naiv në të gjithë botën.



Gjatë muajit Ramazan, për një kohë të caktuar, bëhen të ndaluara edhe marrëdhëniet bashkëshortore. Edhe kjo ndodh gjatë kohës së një profeti, kur besimtarët detyrohen të distancohen nga të afërmit e tyre, herë për shkak të kundërshtimit në besim, e herë për shkak se atyre u duhet të largohen nga shtëpitë e tyre për të përhapur besimin. Pra, ky largim u vjen herë për shkak të mosbesimit të të afërmeve të tyre, e herë për shkak të besimit dhe përgjegjësisë të tyre.

Kështu që, muaji Ramazan nëse në njërën anë, është një sprovë për një individë për besimin dhe përkushtimin e tij dhe do të mbetet i tillë deri në ditën e Kiametit, atëherë, në anën tjetër, ai është një mësim dhe udhëzim për

besimtarët e profetit, të cilët mund të kenë sukses vetëm duke e ndjekur atë. Nëse xhemati i tyre nuk bëhet i gatshëm për të hequr dorë edhe nga të drejtat e tyre dhe nga nevojat e tyre të lejuara, atëherë asnjë individ prej tyre nuk mund të bëhet i dobishëm për xhematin vetëm duke pohuar se i quan haram gjërat që janë haram dhe dëshiron t'i përdorë të gjitha gjërat e lejuara. Gjatë ardhjes së një profeti, vetëm ai mund t'i shërbejë fesë siç duhet, i cili jo vetëm që heq dorë nga gjërat e ndaluara, duke i kujtuar si të ndaluara, por në disa raste, për hir të dobisë së fesë, ndalon për vete edhe disa nga gjërat e lejuara.

Zoti krijon një “kontradiktë” të çuditshme gjatë kohës së profetëve. Disa gjëra që deri para ardhjes së një profeti mbeten të ndaluara, profeti i



shpall të lejuara. Siç është komunikimi me Zotin, takimi me Të. Njerëzit para ardhjes së profetit, këtë gjë e kujtojnë si të ndaluar. Profeti vjen dhe e shpall të lejuar. Po ashtu, ndodh edhe e kundërta: disa gjëra që konsiderohen si të lejuara, madje mbeten të tilla edhe më vonë, gjatë kohës së një profeti bëhen të ndaluara, për shkak të kërkesave të besimit dhe të përhapjes së tij. Mijëra herë ndodh që xhemati i besimtarëve detyrohet të heqë dorë nga të ngrënit e të pirit, nga pronat e tyre, nga dëshirat e tyre joshëse, nga atdhedashuria, të cilën Profeti Muhammed s.a.v.s. e quajti një pjesë të besimit. Pra, të gjitha këto gjëra të lejuara, xhemati i besimtarëve detyrohet t'i quajë të ndaluara për vete. Nëse ndonjë besimtar nuk e bën këtë në kohën kur kërkohet prej tij, atëherë besimi i tij bëhet i pavlefshëm.

Atdhedashuria është pjesë e besimit, por Zoti i Lartësuar nganjëherë urdhëron besimtarin për mërgim dhe ai detyrohet të largohet nga vendi i tij. Po ashtu, Profeti Muhammed s.a.v.s. tha: “Ai që vritet duke mbrojtur pasurinë e tij është dëshmor”¹ por, besimi nganjëherë i kërkon të heqë dorë nga pasuria. Pra, një gjë, që në kohë të tjera mbetet pjesë e besimit, gjatë kohës së profetit, për shkak të kërkesave të fesë, bëhet e ndaluar, madje rreptësisht e ndaluar. Nëse dikush, edhe në ato rrethana, këmbëngul për ta marrë atë, konsiderohet jobesimtar. Kështu që, profetët kur vijnë, disa gjëra të ndaluara i bëjnë të lejuara, e disa gjëra të lejuara i bëjnë të ndaluara. Po të mos ndodhë kjo, nuk mund të vendoset modeli i vërtetë i besimit.

... Kur një popull jeton larg në kohë

nga profeti i tij, atëherë edhe sikur 50 përqind e njerëzve të tij të kenë besimin dhe kalojnë jetën e tyre sipas tij, konsiderohet një arritje e kënaqshme. Por gjatë kohës së profetit, 99 përqind e njerëzve të tij duhet të kenë besimin dhe të kalojnë jetën e tyre sipas tij, sepse nëse populli prishet që në kohën e profetit, atëherë xhemati i tij nuk mund të ruhet. Pas kohës së profetëve, mbrojtja e fesë nuk është më e nevojshme, por praktika e besimtarëve sipas asaj feje, kurse gjatë kohës së profetit mbrojtja e saj është më e nevojshme. Pra, gjatë kohës së profetit, nuk është i nevojshëm vetëm besimi individual, por edhe ai kolektiv. Gjersa nuk lind besimi kolektiv dhe nuk paraqiten sakrificat kolektive, nuk plotësohet qëllimi i ardhjes së profetit. Gjithashtu, derisa nuk plotësohet qëllimi i ardhjes së profetit, populli i tij nuk mund të lirohet nga përgjegjësia e tij, madje do të quhet fajtor, pasi përgjegjësia me të cilën ishte i ngarkuar, nuk e ka përmbushur akoma. Prandaj, çdo Ramazan duhet të na sjellë këtë mësim dhe kujtim që ashtu siç muslimanët janë të obliguar të agjërojnë një muaj në një vit, ne gjithë vitin duhet ta kemi si në muajin e ramazanit. Për ne agjërimet nuk janë vetëm për një muaj, por për dymbëdhjetë muaj. Derisa Islami nuk do të përhapet edhe një herë dhe derisa gjithë njerëzit e botës nuk e përqafojnë fenë Islame, deri atëherë, xhemati ynë nuk ka vetëm një muaj agjërimi, por të gjithë muajt. Shembulli

ynë është njësoj si e atij plakut, të cilin kur dikush e pyeti se sa është nisabi i zekatit, ai i tha: për gjithë të tjerët, 1 për 40 dinarë, por për mua, 41 për 40 dinarë, sepse Zoti ka sjellje të veçantë me mua. Ai Vetë më plotëson të gjitha nevojat dhe kam premtimin e Tij që Ai do të jetë Kujdestari im. Edhe pas këtij premtimi, nëse unë grumbulloj para, atëherë për mua ato nuk janë të lejuara dhe duhet t'i kthej, madje një dinar më shumë si gjobë për shkak se kam menduar për veten kur Zoti i Lartësuar premtoi të më plotësojë të gjitha nevojat. Kjo është gjendja jonë. Për njerëzit e thjeshtë, vetëm një ndër dymbëdhjetë muaj vjen si muaji i agjëtimeve, por për ne gjithë viti duhet të jetë i agjëtimeve, pra gjithë jetën duhet ta kalojmë sikur të jemi në muajin Ramazan. Nuk e kam fjalën që të mbajmë agjërim gjithë vitin, pasi kjo është e ndaluar. E kam fjalën që anëtarët e xhematit tonë duhet t'u nënshtrohen porosive të Allahut në atë mënyrë, që të heqin dorë edhe nga gjërat e lejuara, duke i konsideruar ato si të ndaluara”.

(Fjalimi i xhumasë i mbajtur më 01.09.1944; Khutbat-e-Mahmud vëll. 25, f. 526-532)

E përktheu në shqip: **Samad Ghorî**

¹ Buhariu, *Kitabul-medhalim, bab men ketele dune malithi, hadithi nr. 2480.*

Amtul Q. Farhat

Dobitë shëndetësore të agjërimit



Shkencëtarët thonë se raporti i sheqerit në gjak fillon nga 80-110 mg / 100 cm³, i cili është raporti normal i sheqerit në gjak. Por pas agjërimit për gjashtë orë, ky raport bie.

Këtu ndodh një mrekulli e çuditshme e trupit të njeriut, pasi truri dërgon mesazhe të shpejta për tek gjëndrat endokrine për ndihmë dhe furnizimin me energji.

Gjendra supra-renale prodhon një hormon të veçantë që nxit shndërrimin e niseshtesë - amidonit (latinisht: amulum) të muskujve dhe mëlçisë në sheqer. Po ashtu gjendra tiroide gjithashtu prodhon një hormon të veçantë që nxit sheqerin e ruajtur në muskuj dhe mëlçi për të dalë jashtë dhe për t'u konsumuar.

E gjithë kjo ndodh për shkak se raporti i sheqerit në gjak shkon poshtë pas gjashtë orëve të agjërimit. Një gjëndër tjetër pankreasi gjithashtu prodhon një hormon të veçantë që nxit sheqerin e ruajtur për të dalë jashtë dhe për t'u konsumuar.

Nëse njeriu do të konsumojë të gjithë sheqerin që ka ruajtur në muskujt dhe në mëlçi, yndyrat e depozituara në trup shndërrohen në sheqer që të konsumohet nga trupi.

Kërkimet shkencore konfirmojnë se djegia e yndyrave rritet gjatë orëve të agjërimit, dhe kështu ka konsumim të yndyrave të akumuluar në pjesë të ndryshme të trupit.

Fakti i mahnitshëm në lidhje me trupin e njeriut është që çdo 1 kg i indeve yndyrore i duhen 3 km kapilarë përmes të cilit qarkullon gjaku.

Kjo është një barrë e rëndë për zemrën, por në qoftë se pesha e një personi është 10 kg sipër normales, kjo do të thotë se ai ka 300 km kapilarë shtesë për të cilat

duhet të furnizohet me gjak nga zemra e tij.

Shkencëtarët konfirmojnë që fiziologjia e trupit të njeriut kërkon që njeriu të abstenojë nga ushqimi për periudha të caktuara kohore të mjaftueshme për fazën e parë dhe të dytë të tretjes së ushqimit për t'i ardhur radha proceseve të fazës së tretë për të punuar mirë.

Agjërimi lehtëson proceset e fazës së parë të tretjes së ushqimit dhe thithjen, fazën e dytë të akumulimit të energjisë, si dhe hapat e fazës së tretë të djegies dhe konsumit të energjisë të depozituara në trup.

Kjo do të thotë, agjërimi është i domosdoshëm për njerëzimin! Dhe kjo është arsyeja pse Allahu, Hirploti, i Mëshirshmi, thotë:

“O ju që besuat! Ju obligohen agjërimet ashtu siç u ishin obliguar atyre që ishin para jush, që të bëheni të druajtur... kushdo që bën mirësi shtesë, bën mirë për veten e tij. Dhe nëse agjëroni, është mirë për ju, në qoftë se e dini”.¹

(E përkthyer nga anglishtja: Valdon Mustafa dhe Dukagjin Zeqiraj)

¹ Kurani Famëllartë 2:184-5.



AGJËRIMI

NJË NDËR SHTYLLAT E ISLAMIT

Muhammed Ashraf Zia



“O ju që besuat! Ju obligohen agjërimet ashtu siç u ishin obliguar atyre që ishin para jush, që të bëheni të druajtur. Janë pak ditë të numëruara. Pra, kushdo që është i sëmurë prej jush, ose që gjendet në udhëtim, le ta plotësojë numrin në ditë të tjera. Ata që kanë mundësi, le të ushqejnë një të varfër si shpagim. Pra, kushdo që bën mirësi shtesë, bën mirë për veten e tij. Dhe nëse agjëroni, është mirë për ju, në qoftë se e dini.

Muaji Ramazan është ai në të cilin u zbrit Kurani si udhërrëfyes për njerëzit dhe me shenjat e qarta që përbëhen nga shpjegimet e udhëzimit dhe çështjet dalluese (të së vërtetës nga e rrema). Kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë në të. Kurse ai që është i sëmurë, ose që gjendet në udhëtim, le të plotësojë numrin në ditë të tjera. Allahu do lehtësi për ju dhe nuk do vështirësi për ju dhe do që ju (lehtësisht) ta plotësoni numrin e ditëve, ta madhëroni Allahun për shkak se ju udhëzoi dhe që

të bëheni mirënjohës”.¹

Feja Islame ka pesë shtylla kryesore: Shehadeti, namazi, agjërimi, haxhi dhe zekati. Në ajete të lartpërmendura Allahu i Lartësuar ka shpalosur porosinë për të agjëruar. Në arabisht, për agjërimin përdoret fjala saum që do të thotë për të mbajtur apo për të ndaluar diçka. Në terminologjinë Islame, agjërimi nënkupton ndalimin prej të ngrënit e të pirit nga agimi deri në përfundimin e diellit, dhe për t’i ndërprerë marrëdhëniet bashkëshortore gjatë asaj kohe, me qëllim për të adhuruar Zotin.

Njëherë po afrohej muaji i bekuar i Ramazanit në kohën e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s} Ishte dita e fundit e muajit Shaban, dhe Pejgamberi ^{s.a.v.s} iu drejtua sahabëve, për t’ua njohur vlerat dhe madhësitinë e këtij muaji. Hazret Selman el-Farisiu ^{r.a} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s} tha:

“O njerëz! Po ju afrohet një muaj madhështor, për t’ju hijesuar. Është një muaj i bekuar, në të cilin gjendet një natë e cila (nga dobitë dhe madhësititë e saj) është më e mirë sesa një mijë muaj. Allahu i Lartësuar ju ka obliguar agjërimin në të dhe adhurimin gjatë netëve të tij, e ka bërë vullnetar. Nëse njeriu me anë të ndonjë adhurimi të tij vullnetar gjatë këtij muaji synon të fitojë afërsinë me Zotin, do të shpërblehet barabartë me shtatëdhjetë vepra të obligueshme në ditët e zakonshme. Ky është muaji i durimit dhe durimi

i Dërguari i Allahut ^{s.a., v.1, 5.}

ka thënë:

*“Ai që agjëron duke besuar
singerisht dhe duke shqyrtuar
veten, i falen gjynahet e
mëparshme.*

*Po të kishit ditur dobitë
dhe vlerat e këtij muaji, ju
sigurisht do të dëshironit që i
gjithë viti të ishte ramazan”.*

shpërblehet me xhenet. Ky është muaji i dashurisë dhe dhembshurisë, gjatë të cilit shtohet dhe begatohet furnizimi i besimtarit. Nëse dikush ia çel agjërimin agjëruesit, atij i shlyhen mëkatet dhe ai shpëton nga zjarri. Njeriu i tillë shpërblehet njësoj si agjëruesi, pa ia pakësuar asgjë nga shpërblimi i tij. Fillimi i këtij muaji është mëshira, kulmi është falja dhe përfundimi është shpëtimi nga zjarri. Gjatë këtij muaji, Allahu e fal edhe atë dhe e çliron nga zjarri, që ia lehtëson detyrën punëtorit apo shërbëtorit të tij”.²

Ebu Hurejre ^{r.a.} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a., v.5.} ka thënë se:

“Kur vjen nata e parë e Ramazanit, u vihen pranga djajve dhe xhindëve. Mbyllen portat e xhehenemit derisa

nuk i mbetet asnjë portë e hapur. Çelen dyert e xhenetit, derisa nuk i mbetet asnjë derë e mbyllur. Një thirrës u bën thirrje duke thënë: o kërkues i mirësisë! Eja dhe dil përpara. O kërkues i ligësisë! Ndal. Mjaft shpirtra çlirohen nga zjarri për hir të Allahut dhe kjo ndodh në çdo natë të Ramazanit”.³

Për të kuptuar se çfarë rëndësie i ka kushtuar i Dërguari i Allahut ^{s.a., v.5.} kësaj shtylle themelore të Islamit, dua t’ju parashtroj disa hadithe:

Ebu Hurejre ^{r.a.} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a., v.5.} ka thënë:

“Ai që agjëron Ramazanin duke besuar singerisht dhe duke shpresuar shpërblimin për të, do t’i shlyhen të gjitha mëkatet e mëparshme”.⁴ Abdurrahman bin A’uf ^{r.a.} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a., v.5.} shpjegoi rreth Ramazanit dhe e quajti muajin më të mirë dhe tha:

“Nëse dikush adhuron Zotin me bindje dhe duke shqyrtuar veten imtësisht gjatë muajit Ramazan, shpëton nga gjynahet sikur ishte kur kishte dalë nga barku i nënës”.⁵

Ebu Hurejre ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a., v.5.} ka thënë:

“Ai që agjëron duke besuar singerisht dhe duke shqyrtuar veten, i falen gjynahet e mëparshme. Po të kishit ditur dobitë dhe vlerat e këtij muaji, ju sigurisht do të dëshironit që i gjithë viti



të ishte ramazan”.⁶

Ebu Mes’ud Gafari ^{r.a.} transmeton se pas ardhjes së muajit Ramazan, e dëgjova të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} duke thënë:

“Sikur të dinin rëndësinë e Ramazanit, ndjekësit e mi do të kishin dëshirë që i gjithë viti të ishte Ramazani”. Dikush e pyeti: “O i Dërguar i Allahut! Na tregoni vlerat e Ramazanit. Ai i tha: Zbukurohet xheneti që nga fillimi i vitit për muajin Ramazan. Kur bie dita e parë e Ramazanit, fryjnë erërat poshtë Arshit të Allahut”.⁷

Enes bin Maliku ^{r.a.} transmeton se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë se :

“Ramazanit i është vënë ky emër sepse ai i zhurit dhe shkrumbon gjynahet”.⁸

Ebu Hurejrah ^{ra} rrëfen se Pejgamberi ^{sas} ka thënë:

“Agjërimi është mburoja dhe kalaja e

pamposhtur që mbron nga zjarri”.⁹

Selman el-Farisiu ^{r.a.} përcjell se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë se:

“Ramazani është i atillë muaj, fillimi i të cilit është zbritja e mëshirës, pjesa e mesme është falja prej Zotit dhe fundi i tij është shpëtimi nga zjarri”.¹⁰

Enes bin Maliku ^{r.a.} transmeton se kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ^{s.a.v.s.} duke thënë se:

“Ja ka ardhur muaji Ramazan. Në të çelen dyert e xhenetit, ndërsa mbyllen dyert e xhehenemit dhe djajve u vihen pranga. I humbur qoftë ai i cili e gjeti Ramazanin, por nuk arriti dot shpëtimin prej mëkateve. Po nuk shpëtoi në Ramazan, kur do të shpëtojë ai?”¹¹

Ebu Hurejre ^{r.a.} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë se kur bie nata e parë e Ramazanit, Allahu i Lartësuar

shikon te krijesa e Tij, dhe kur Ai sheh ndonjërin prej robërve të Tij, Ai nuk e ndëshkon kurrë. Allahu i Lartësuar çdo ditë shpëton qindra mijëra njerëz nga xhehenemi. Kur bie nata e 29-të e Ramazanit, Allahu i Lartësuar fal aq shumë njerëz, sa kishte falur gjatë 28 netëve të kaluara të Ramazanit.”¹²

Ibni Abasi ^{r.a.} tregon se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ishte njeriu më bujar. Sidomos gjatë Ramazanit, bujaria e tij shfaqej në mbushullim, dhe zemërgjerësia e tij shpërfaqej gjithkund si një furtunë e vullshme.¹³

Aisheja ^{r.a.} rrëfen se përkushtimi, mundimi dhe angazhimi që i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ndërmernte për të adhuruar Zotin gjatë Ramazanit, nuk dukeshin gjatë ditëve të tjera.¹⁴

Selman el-Farisiu ^{r.a.} transmeton se Pejgamberi ^{s.a.v.s.} ka thënë:

“Allahu i Lartësuar ka obliguar agjërimin gjatë ditëve të Ramazanit, ndërsa adhurimin gjatë netëve të tij, e ka cilësuar si vullnetar. Ky është muaji i durimit, dhe shpërblimi i durimit është xheneti. Ky është muaji i dhembshurisë në të cilin shtohet dhe begatohet furnizimi i besimtarit”.¹⁵

Ky durim nuk shfaqet vetëm përballë urisë dhe etjes, madje besimtari përmbahet jo vetëm përballë dëshirave të shturura por edhe kur përballen me sjellje të papëlqyeshme nga të tjerët.

Ebu Hurejre ^{r.a.} përcjell se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

“Agjërimi është mburoja, andaj

agjëruesi duhet t’u shmanget bisedave të pahijshme dhe nuk duhet të bëjë veprime të kohës së injorancës. Nëse dikush zihet me të apo i drejtohet me fjalë të rënda, ai duhet të përgjigjet dy herë duke thënë: “Unë jam agjërueshëm”.¹⁶

Mesihu i Premtuar ^{a.s.} duke përshkruar shkallën më të lartë të kësaj vetëpërmbytje, shkruan:

“Unë mund të përmbaj veten time dhe Zoti i Lartësuar ka nënshtuar qenien time deri në atë shkallë sa që edhe nëse dikush më drejtohet me fjalët më të rënda e të pahijshme për një vit radhazi, përfundimisht vetë ai do të turpërohet dhe do të detyrohet për të pranuar se nuk arriti të më lëkundte nga qëndrimi im”.¹⁷

Muaji Ramazan mban vlera të mëdha dhe bekime të pallogaritshme. Mesihu i Premtuar ^{a.s.} duke shpjeguar madhështinë e këtij muaji dhe bekimet e agjërimit shkruan:

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ

vetëm kjo fjali mjafton për të mësuar madhështinë e këtij muaji. Sufijtë kanë shkruar se ky është muaji më i mirë për të ndriçuar shpirtin. Nëse namazi e pastron nefsën (shpirtin), agjërimi e ndriçon zemrën. Pastrimi i shpirtit nënkupton çlirimin nga epshet e gjendjes instinktive, kurse ndriçimi i zemrës do të thotë se robi të gëzojë keshfin, pra të shikojë Zotin. Andaj,

أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ

i referohet pikërisht kësaj gjendjeje, dhe nuk ka asnjë dyshim në të. Agjërimi

sjell shpërblime shumë të mëdha, por sëmundjet dhe interesat e privojnë njeriun nga kjo dhunti. Më kujtohet se gjatë rinisë sime, kisha parë në ëndërr se agjërimi është suneti i Ehli-Bejtit (d.m.th. të familjes së Profetit ^{s.a.v.s.}) e prandaj unë agjërova për gjashtë muaj radhazi. Gjatë kësaj periudhe pashë (në ëndërr) se shtylla dritash ngriheshin njëra pas tjetrës në qiell. Nuk jam i sigurt se ato shtylla dritash a ngriheshin nga Toka apo nga zemra ime? Megjithatë, kjo mund të realizohet gjatë rinisë dhe po të doja, mund të kisha agjëruar për katër vjet.

... Porositë e Zotit të Lartësuar ndahen në dy kategori: 1) Adhurime që lidhen me pasuri, 2) Adhurime që lidhen me trup. Adhurimet me anë të pasurisë i përkasin vetëm atij që gëzon të mirat materiale, ndërsa i varfri përjashtohet prej tyre. Edhe adhurimet trupore mund të kryhen vetëm gjatë periudhës rinore, ndryshe në të gjashtëdhjetat njeriun e zënë lloj-lloj sëmundjesh, katarakti etj., i dobësojnë shikimin. Është e vërtetë se pleqëria vjen me qindra sëmundje, andaj njeriu edhe gjatë pleqërisë përfiton për punën që ka bërë në rininë e tij, ndërsa ai që nuk ka bërë asgjë në rini, edhe në pleqëri përballet me trishtim. Thuhet se thinja është mesazhi që njeriut po i afrohet fundi, andaj ai është i detyruar të përmbushë sipas mundësisë obligimet e tij ndaj Zotit. Lidhur me agjërimin, Zoti ka thënë وَأَنْ تَصُومُوا خَيْرٌ لَّكُمْ d.m.th. nëse agjëroni, është më mirë për ju”.¹⁸

Hazret Kalifi I ^{r.a.} ka thënë:

“Mësimi më kryesor i Ramazanit është që pavarësisht nga nevojat sado të rëndësishme, rob i sinqertë i Zotit për hir të kënaqësisë së Tij, i mposht të gjitha ato dhe nuk u trembet aspak. Kurani i Madhërishëm duke vënë në pah esencën dhe filozofinë e vërtetë të agjërimin, thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ

كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

Ju obligohet agjërimi me qëllim të përvetësoni takvanë (druajtjen ndaj Zotit). Agjëruesi, vetëm për hir të Zotit, braktis edhe ato gjëra, që sheriat i ka lejuar dhe nuk ia ka ndaluar përdorimin e tyre. Por, meqë Zoti nuk e lejon në këto momente, nuk mundet që ai të përpikët për t’i arritur ato gjëra, që sheriat i ka ndaluar, apo të përdorë gjëra të ndaluara, ose të shfryjë epshin në sjellje të pakontrolluara. Një ndër kushtet e takvasë është të mos rrëmbehet pasuria e dikujt tjetër”.¹⁹

Imami ynë i dashur Kalifatul Masih V (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) ka porositur se:

“Ramazani është muaji i bekimeve për ata që duan të adhurojnë Zotin sinqerisht. Ky është muaji i bekimeve për ata të cilët duke iu nënshtruar të gjitha porositë të Allahut, mundohen të përmbushin çdo vepër të mirë, për të cilën ka porositur Allahu, dhe përpiqen t’i shmangen çdo vepër të keqe, të cilën ka ndaluar Ai. Madje, për një kohë të caktuar, ata largohen edhe nga gjëra

të lejueshme. Allahu i Madhërishëm ka thënë se obligimi i agjërimit dhe shmangja prej disa gjërave kanë për qëllim për t'ju lartësuar në takva. Çfarë është takvaja? Takvaja do të thotë të ruheni nga gjynahet, të bëni përpjekje për t'u mbrojtur prej tyre dhe të ruheni ashtu

agjërimit duke gjetur arsye të dobëta. Për ata që nuk agjërojnë qëllimisht, i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

“Ai që lë agjërimin e Ramazanit qoftë edhe për një ditë të vetme, pa pasur asnjë arsye të shëndoshë, nuk mund ta kompensojë atë, edhe nëse agjëron



siç ruhet duke qëndruar pas mburojës. Kur njeriu qëndron pas diçkaje për t'u mbrojtur nga sulmet, atëherë atë e zë edhe frika. Ai fshihet mbrapa pikërisht duke iu frikësuar sulmit. Prandaj kur ju thuhet të agjëroni, duhet të agjëroni duke respektuar kushtet e agjërimit e kështu do të përparoni në takva”.²⁰ Nuk është e drejtë t'i shmangemi

gjithë jetën”.

Mesihu i Premtuar ^{a.s.} ka thënë:

“Po të kishte dashur Zoti, do t'ia kishte hequr edhe këtë ummeti të gjitha obligimet sikur feve të tjera, por këto obligime shërbejnë për t'i sjellë dobi njeriut. Në mendimin tim, nëse njeriu i lutet Zotit sinqerisht dhe përlësisht për t'u mos privuar prej bekimeve të

këtij muaji, Zoti i Lartësuar nuk e privon atë, madje edhe nëse ai sëmuret në Ramazan, sëmundja e tij bëhet mëshirë për të, sepse veprat varen nga nijeti (qëllimi). Besimtari duhet të tregohet trim në rrugën e Zotit. Nëse dikush mbetet i privuar nga agjërimet, edhe pse kishte dëshirë të sinqertë se nëse do të ishte i mirë e shëndoshë, do të agjëronte, dhe tashmë zemra i përmallohet me këtë dëshirë, atëherë engjëjt agjërojnë për të. pra, nëse njeriu nuk sillet me hile, edhe Zoti i Lartësuar kurrë nuk e privon atë nga shpërblimi.

Kjo është një çështje e thellë. Nëse dikush për shkak të përtesës së tij, kujton se agjërimi është i rëndë për të, apo kujton se është i sëmure dhe nëse nuk ushqehet për një kohë, do të sëmuret menjëherë, apo do t'i ndodhin këto apo ato gjëra, dhe bekimin e Zotit e konsideron si gjobë ndaj vetes, njeriu i tillë nuk mund të meritojë mirësitë e Zotit. Por, ai që e pret Ramazanin me përmallim e gëzim, me dëshirë që të agjëronte, por për shkak të sëmundjes nuk agjëroi dot, njeriu i tillë nuk mbetet i privuar nga agjërimi në qiell. Bota ka shumë njerëz që sillen me dredhi dhe kujtojnë se ashtu sikur i kanë gënjyer njerëzit e kësaj bote, do t'i bëjnë hile edhe Zotit. Hileqarët vet i sajojnë arsyet, e pastaj duke shtuar përligjet, i konsiderojnë ato të drejta e të mirëqena. Por, në sy të Zotit ato nuk janë të drejta. Çështja e formalitetit dhe gjetjes së lehtësisë është mjaft e gjerë, dhe po të

dojë njeriu mund të kryejë namazin tërë jetën duke u ulur, apo të mos agjërojë kurrë.

Por, Zoti e njeh mirë nijetin dhe qëllimin e atij që është i sinqertë dhe i përvur. Zoti i Madhërishëm e di që ai njeri ka një zemër të dhembshur, dhe meqë dhembshuria dhe mallëngjimi janë veti të çmueshme, Zoti e shpërblen më shumë. Por, hileqarët mbështeten në arsyetime, edhe pse para Zotit ato nuk qëndrojnë aspak. Kur kisha agjëruar për gjashtë muaj radhazi, kisha takuar një grup profetësh (në ëndërr). Ata më pyetën se përse po e mundoja aq shumë veten time, dhe të ndërprisja agjërimin. Ashtu ngjan kur njeriu e mundon dhe sflit veten për hir të Zotit, Ai tamam si një prind i drejtohet robit me mallëngjim se përse e sflit veten.

Ndërsa të tjerët, përmes arsytimit të dobët, e kanë privuar veten nga mundimet. Andaj, kur Zoti i sprovon kësisoj njerëzish dhe u shkakton mundime të rënda, Ai nuk i privon prej tyre. Ndërkohë, ata që e mundojnë veten për hir të Tij, Zoti vetë i shpëton prej tyre. Njeriu nuk duhet të tregohet i mëshirshëm ndaj vetes, madje duhet që të tërheqë mëshirën e Zotit. Mëshira e njeriut ndaj vetes është xhehenem, ndërsa mëshira e Zotit është xhenet për të.

Reflektoni mbi ngjarjen e Ibrahimit ^{a.s.}. Ai dëshironte të hidhej në zjarr, ndërsa Zoti e shpëtoi nga zjarri. Ata që duan të ruhen nga zjarri, janë ata që hidhen në



zjarr. Ky është Islami, që njeriu t'i mos i frikësohet asgjëje që i del në rrugën e Zotit. Po të kujdesej i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} për të ruajtur veten, nuk do të shpallej ajeti ^{وَاللَّهُ يُعَذِّبُكَ مِنَ النَّاسِ} d.m.th. Allahu do të ruajë ty nga njerëzit. (el-Maidah 5:68). Ky është sekreti i mbrojtjes së Allahut”.²¹

Mesihu i Premtuar ^{a.s.} thotë se:

“Unë jam i tillë që nuk e lë agjërimin veçse kur gjendja ime i ngjan vdekjes. Natyra ime nuk pajtohet me lënien e agjërimit. Këto janë ditë të bekuara, në të cilat zbresin mirësia dhe mëshira e Zotit”.²²

Kalifi II i Mesihut të Premtuar ^{r.a.} ka thënë:

“Njoh disa persona që e konsiderojnë obligimin e agjërimit si diçka të

parëndësishme, dhe e lënë agjërimin për arsyeje shumë të vogla. Madje, nganjëherë ata e lënë agjërimin vetëm duke menduar se do të bien në ndonjë sëmundje. Sigurisht, kjo nuk është asnjë arsye që dikush mendon se do të sëmuret. ... Nuk është e drejtë të shmanget agjërimi për një sëmundje që nuk ndikohet aspak nga agjërimi”.²³

Hazret Kalifi II ^{r.a.} gjithashtu ka thënë:

“Sheriati i ka dhënë rëndësi të madhe çështjes së agjërimit. Megjithatë nëse në një anë, nuk pëlqehet qëndrimi ekstrem në zbatimin e kësaj dispozite, po ashtu nuk lejohen as lëshime të tepërta. Prandaj, nuk duhet zbatimi aq rigoroz dhe ekstrem saqë njeriu të vdesë, e as lehtësirat e skajshme që të shkelet nëpërkëmbë urdhri i shariatit



dhe të anashkalohen detyrimet me hile e përligjeje. Unë kam parë vetë se mjaft persona nuk agjërojnë thjesht duke arsyetuar se janë të dobët fizikisht. Disa thonë se po të agjërojnë, menjëherë i kap heqje të shpeshta barku, edhe pse dizenteria nuk përbën arsye të mjaftueshme për të lënë agjërimin. Derisa nuk vuan nga heqje të shpeshta barku, njeriu duhet të agjërojë, e nëse vuan prej saj, atëherë le ta ndërpresë agjërimin. Disa thonë se agjërimi u shkakton dobësinë fizike, por edhe kjo nuk është ndonjë arsye e mirëfilltë. Lejohet lënia a agjërimit vetëm në rast se udhëzon mjeku”.²⁴

Hazret Kalifi IV ^{r.a.} ka thënë:

“Ata që nuk agjërojnë gjatë muajit Ramazan, nuk kanë haber se prej çfarë

mirësish po mbeten të privuar. Ata nuk duruan urinë e disa ditëve, nuk përballuan dot pengesat e disa ditëve dhe kështu mbetën të privuar nga dobi të shumta. Ata u prangosën ende më shumë në dynja, sepse njeriu që nuk i duron dot kufizimet e Ramazanit, sjellja e tij mbizotërohet nga lidhjet e dynjasë. Njeriu i tillë është vetë shkaktar për shtrëngimin e tij në prangat e materializmit. Të tillë njerëz ditë për ditë bëhen sklevër të një jete të poshtër, e pastaj pavarësisht nga dëshirat nuk lirohen dot prej këtyre lidhjeve. Prandaj, është një vendim i rëndësishëm që shtrëngimet e ditëve të Ramazanit të pranohen me gëzim dhe zell të madh.

Nëse do t’i pranoni këto shtrëngime, do të mësoni sesa shumë dobi të



pakufizueshme mbajnë ato. Mundimet e disa ditëve, do t'ju sjellin aq shumë fitime, që do t'ju ushqejnë gjatë gjithë vitit”.²⁵

Nëse dikush nuk ka përfitur nga bekimet e Ramazanit, dhe po mbetet i privuar edhe nga ibadetet dhe dobite e tjera, ai duhet të bëjë lutjen e Mesihut të Premtuar ^{a.s.}. Ai ka thënë:

“Sipas meje, mjafton që njeriu ta bëjë këtë lutje se: o Allah! Ky është muaji yt, ndërsa unë po mbetem i privuar prej tij. Nuk dihet a do të jem i gjallë vitin e ardhshëm apo jo. Nëse njeriu i lutet Zotit në këtë mënyrë duke i kërkuar fuqi për Ramazanin, jam i bindur se Zoti i Lartësuar do t'ia forcojë zemrën”.²⁶

Agjërimi është shërim edhe për sëmundjet trupore. Ebu Hurejre ^{r.a.} ka përcjellë se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë: “Për çdo gjë ekzistua një zekat që e delirëson atë, dhe zekati i trupit dhe mjeti për bukurinë dhe hijeshinë e

tij të brendshme dhe të jashtme është agjërimi.” (Ibni Maxhe, libri i agjëritimit) Në një hadith, transmetohet se Profeti ^{s.av.s.} ka thënë: “Agjëroni që të jeni të shëndetshëm”.²⁷

Kalifi II ^{r.a.} ka thënë:

“Agjërimi shërben për të shëruar sëmundje të llojllojshme. Sipas studimeve të fundit, është zbuluar se pleqëria dhe dobësia vijnë sepse formohet substanca e panevojshme në trup, e cila shkakton sëmundjen apo vdekjen e menjëhershme, ndërsa agjërimi është shumë i dobishëm për të”.²⁸

Hazret Kalifi IV ^{r.a.} duke shtruar ndikimin e agjëritimit mbi trupin e njeriut ka thënë:

“Në Ibni Maxhe gjendet një transmetim i Ebu Hurejres ^{r.a.}. Sipas këtij hadithi, për të pastruar çdo gjë, ekziston njëlloj zekati, dhe zekati i trupit si mjet për



ta zbukuruar atë është agjërimi. Zekati paguhet edhe për të pastruar paratë, si dhe për të stimuluar veprat. Të dyja këto kuptime gjenden njëkohësisht në të. Pra i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë se agjërimi bëhet zekat për të gjithë trupin. Një tjetër hadith e shtjellon këtë me fjalët صوموا تصحوا d.m.th. nëse do të agjëroni, do të bëheni të shëndetshëm. Pra, nuk është vetëm zekati shpirtëror por edhe ai fizik. Me mëshirën e Zotit, përgjatë Ramazanit, kundër perceptimit të përgjithshëm, shëndeti përmirësohet dhe nuk përkeqësohet, përderisa njeriu e respekton lejen që i jepet në rastin e sëmundjes. Pra, derisa vetë Allahu ka përjashtuar të sëmurit nga obligimi i agjërit, kundërshtimi dhe shpërfillja ndaj këtij kushti do të përkeqësojë shëndetin. Ramazani e gjallëron shëndetin e jo ta prishë atë.

Nuk duhen lënë agjërimet duke arsyetuar kushte të rënda të motit, punë, shkollë apo shkaqe të tjera. Allahu e ka obliguar agjërimin dhe nuk ka dhënë lehtësime

për shkak të ndryshimit të stinës apo angazhimit në punë. Përjashtimin e bëjnë vetëm të sëmurët dhe udhëtarët. Përveç këtyre rasteve, njeriu nuk duhet të privojë veten nga bekimet dhe faljet e Allahut.

Profeti ynë i dashur ^{s.a.v.s.} ka thënë se الصوم في الحرجه d.m.th. agjërimi gjatë kohës së nxehtë është përpjekje në sy të Allahut. Nuk ka rëndësi se në cilën kohë bie Ramazani, shpirti i tij gjithmonë mbetet adhurimi, heqja dorë nga mëkatet dhe përpjekjet për të fituar dashurinë e Zotit. Allahu na mundësoftë të përfitojmë mjaftueshëm nga ky muaj i begatshëm, Amin!

Hazret Mirza Bashir Ahmedi ^{r.a.} shkruan:

“Mesihu i Premtuar ^{a.s.} thoshte se lënia e mëkateve lypset për një mjedis të përshtatshëm dhe i tillë mjedisi krijohet përsosmërisht në muajin Ramazan. Njerëzve u duhet që duke reflektuar mbi gjendjen e tyre, të zotohen për të hequr dorë qoftë nga ndonjëra prej dobësive personale”.²⁹

Kalifi V i Mesihut të Premtuar (Allahu e ndihmoftë fuqimisht) shpesh ka shpjeguar rëndësisë e reflektimit dhe vetëkontrollit. Në një rast ai tha:

“Ne mund të zbulojmë nivelet e agjërit tonë dhe përparimin tonë

*“Lënia e mëkateve lypset
për një mjedis të përshtatshëm
dhe i tillë mjedis
krijohet përsosmërisht
në muajin Ramazan.
Njerëzve u duhet
që duke reflektuar
mbi gjendjen e tyre,
të zotohen
për të hequr dorë qoftë nga
ndonjëra
prej dobësive personale”.*

drejt druajtjes së Zotit, vetëm kur jemi duke kontrolluar veten tonë. Kur nuk jemi duke nuhatur të metat e të tjerëve, por gjurmojmë dobësitë tona. Kur jemi duke analizuar se çfarë veprash të mira kemi kryer sot apo jemi përpjekur t'i përmbushim dhe prej sa veprash të këqija jemi larguar”.³⁰

Pastaj ai thotë:

“Çdo njeri duhet të kontrollojë nefsin e tij gjatë agjërimit. Gjatë muajit Ramazan, ai duhet të reflektojë mbi gjendjen e tij, për të analizuar dobësi që gjenden në të. Le të shikojë se cilat janë ato dobësi që ai mund të përzë lehtësisht dhe cilat janë ato vepra të pëlqyeshme që ai duhet të realizojë. Ai gjithashtu duhet të nënvizojë ato virtyte, që janë për t'u përvetësuar. Nëse çdo njeri përpiket sinqerisht për të përvetësuar dy apo tri

virtyte dhe njëkohësisht bën përpjekje të sinqerta për t'u larguar nga një apo dy vese, atëherë jini të sigurt që keni përfituar maksimumin nga bekimet e Ramazanit”.³¹

Si mund të përfitojmë nga ky muaj i begatshëm, këtë e ka sqaruar Hazret Mirza Bashir Ahmedi ^{r.a.} në një shkrim. Ai shkruan:

“Miqte e mi duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të përfituar gjerësisht nga dobët e Ramazanit, dhe aq sa kanë mundësi përveç arsyeve që parashikon sheriat (d.m.th. sëmundje apo udhëtimi) nuk duhet të lënë agjërimin. Edhe në rastin e përjashtimit, ata duhet të paguajnë fidje sipas praktikës së Sunetit.

Gjatë këtij muaji, përveç pesë namazeve të obligueshme, ata duhet të falin veçanërisht edhe namazin e natës. Ata që kanë mundësi, le të falin edhe namazin duha, i cili e mundëson njeriun të përkujtojë Zotin pas një pushimi të gjatë dhe ia gjallëron shpirtin e përgjumur. Koha e këtij namazi le të llogaritet afërsisht ora 09:30. Namazi i teravisë që falet pas jacisë, është një zëvendësim i ulët i namazit të tahaxhudit, por është një mundësi e artë për njerëz të dobët dhe të sëmurë. Ata që kanë mundësi le të përfitojnë prej të dyjave.

Gjatë këtij muaji, duhet përkushtuar



një vëmendje të veçantë recitimit të Kuranit Famëlartë. E mira është që të recitohet Kurani dy herë, përndryshe le të lexohet të paktën një herë. Kur lexojmë për mëshirën e Zotit, duhet t'ia kërkojmë mëshirën, dhe kur lexojmë për ndëshkimin e Zotit, duhet t'i kërkojmë falje.

Gjatë këtij muaji duhet t'i japim rëndësi të posaçme lutjes dhe të përkujtuarit të Allahut. Kur lutemi, gjendja jonë duhet të jetë e tillë, sikur gjendemi mu në praninë e Zotit, pra Ai na sheh dhe ne e shohim. Në lutjet tona, duhet të lutemi veçanërisht për shëndet dhe jetë të gjatë të Kalifit V (Allahu e ndihmoftë fuqimisht), për misionarët, shërbëtorët e Xhematit, dervishët e Kadijanit. Në lutjet e përgjithshme, رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ (el-Bekare 2:202) është një lutje e mrekullueshme, ndërsa për pastrimin e shpirtit لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ (el-Enbija 21:88) ka fuqi të jashtëzakonshme, ndërsa për t'i kërkuar ndihmë Allahut lutja

يَا حَيُّ يَا قَيُّوْمُ بِرَحْمَتِكَ نَسْتَغِيْثُ është ndër më të suksesshmet. Për sa i përket el-Fatijasë, ajo është mbretëresha e lutjeve.

Dërgimi i salavateve gjithashtu ka rëndësi themelore për t'i tërhequr këto bekime. Mesihu i Premtuar a.s. ka shkruar se një natë bëra aq shumë salavate sa që i gjithë shpirti dhe zemra ime u aromatizuan. Po atë natë pashë një ëndërr se engjëjt hynin në shtëpinë time duke mbushur shishe të mbushura me dritë. Njëri prej tyre m'u drejtua duke thënë se ky nur është shpërblimi i atyre salavateve të cilat ti i ke dërguar Muhammedit ^{s.a.v.s.}.

Gjatë ditëve të shënuara të Ramazanit, njeriu duhet t'u shmanget sjelljeve të papëlqyeshme, fjalëve të ndyra, gënjeshtres, mashtrimit, dredhisë, mizorisë, dhunës, përbuzjes, përgojimit dhe grindjes etj., deri në atë mënyrë sikur ai nuk i njeh aspak këto vese. Duke synuar këtë qëllim, mësimi i Ramazanit do të bëhet si fener i cili ndriçon edhe muaj të tjerë të vitit.

Një ndër adhurimet e rëndësishme të Ramazanit, i cili lidhet me të drejtat e njerëzve, është dhënia e sadakasë dhe lëmoshës. Në hadith thuhet se gjatë ditëve të Ramazanit bujaria e të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.} ngjasonte me një furtunë që nuk e njihte asnjë pengesë. Në fund të Ramazanit sadakaja e fitrit është e obligueshme mbi çdo musliman e muslimane të rritur apo të mitur.

Dhjetëditëshi i fundit i Ramazanit mban rëndësi të veçantë për nga bekimet dhe pranimin e lutjeve. Gjatë kësaj periudhe, besimtari duhet të angazhohet në nafle, përkujtimin e Allahut, lutje, recitimin e Kuranit dhe dërgimin e salavateve. Ata që kanë mundësi, dhe nuk i pengojnë detyrat e tyre, mund të fitojnë edhe bekime të veçanta shpirtërore me anë të i'tikafit pra duke qëndruar në xhami gjatë dhjetëditëshit të fundit. Përndryshe, të paktën duhet t'u përkushtohen veçanërisht nafleve, përkujtimit të Allahut dhe lutjes gjatë netëve të këtij dhjetëditëshi të fundit e në mënyrë të veçantë përgjatë netëve teke. Nëse do Allahu, ata mund të gëzojnë edhe atë natë të bekuar, e cila konsiderohet më e mirë se e gjithë jeta e njeriut. Allahu na mundësoftë të përfitojmë bekimet e këtij muaji madhor dhe na sjell të ndryshime të pastra në qenien tonë, dhe na mbarësoftë jetën tonë shpirtërore dhe atë materiale, Amin!³²

Referenca:

- 1 Kurani Famëlarë 2:185,186.
- 2 Imam Bejhaki, *Shi'ubul Iman*, nr. 3608.
- 3 Tirmidhiu, libri i agjërimit, hadithi nr. 682.
- 4 Buhariu, Libri i agjërimit, hadithi nr. 1768.
- 5 Sunen Nisai, *Kitabus-Sijam*, hadithi nr. 2179.
- 6 El-Xhamiu's Sahih, *Musned el-Imamurabi' bin Habib*, hadithi nr. 331, *Mekteba Mesket, Oman* 2003, f. 150.
- 7 Et-Terghibu vet-Terhib (Inkurajimi dhe kërcënimi), Libri i agjërimit.
- 8 El-Firdaus bi mathuril-Khatah, vëll. 2, hadithi nr. 2339, f. 60.
- 9 Musned Ahmed, hadithi nr. 8857.
- 10 Misbkat, Libri i agjërimit.
- 11 Et-Terghibu vet-Terhib (Inkurajimi dhe kërcënimi), Libri i agjërimit.
- 12 Et-Terghibu vet-Terhib (Inkurajimi dhe kërcënimi), Libri i agjërimit.
- 13 Buhariu, Libri i fillimit të shpalljes, hadithi nr. 5.
- 14 Muslimi, Libri i i'tikafit, hadithi nr. 2644.
- 15 Misbkat, *Kitabus-Saum, etb-Thalis*.
- 16 Buhariu, Libri i agjërimit, hadithi nr. 1761.
- 17 Mefuzat, vëll. I, f. 302.
- 18 Gazeta Badr, 12 dhjetor 1902, f. 52, Tefjir i Mesibut të Premtuar a.s., *surja el- Bekare*, f. 264.
- 19 El-Hakem, 24 janar 1904, f. 12.
- 20 Fjalimet e Masurit, vëll. II, f. 740.
- 21 Mefuzat, vëll. II, f. 565-563, boim 2003.
- 22 Mefuzat, vëll. II, f. 440.
- 23 Gazeta el-Fadl, 11 prill 1925.
- 24 Tefjir Kebir, el-Bekare, f. 286.
- 25 Fjalimi z të xhumasë i mbajtur më 15 prill 1988.
- 26 Mefuzat, vëll. II, f. 563.
- 27 Xhamius-Sagir, es-Sujuti.
- 28 Tefjir Kebir, vëll. II, f. 375.
- 29 Gazeta El-Fadl, 27 prill 1955.
- 30 Fjalimet e Masurit, vëll. 3, f. 601.
- 31 Hythet e Masurit, vëll. I, f. 418.
- 32 Gazeta el-Fadl, 8 mars 1960, Rabwah, Pakistan.

E përktheu në shqip: **Shahid Ahmad**

Lutje e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} për bashkimin, paqen dhe vlerat pozitive

Hazret Abdullah Ibni Mesudi r.a. rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ia mësoi këtë lutje që ta bënte pas teshehudit:

اَللّٰهُمَّ عَلٰى الْخَيْرِ قُلُوْبَنَا، وَاصْلِحْ ذَاتَ بَيْنِنَا وَاهْدِ سُبُلَ السَّلَامِ،
وَنَجِّنَا مِنَ الظُّلُمَاتِ اِلَى النُّوْرِ، وَجَنِّبْنَا الْفَوَاحِشَ وَالْفِتَنَ، مَا ظَهَرَ مِنْهَا
وَمَا بَطَّنَ، وَبَارِكْ لَنَا فِيْ اَسْمَاعِنَا وَاَبْصَارِنَا وَقُلُوْبِنَا وَاَزْوَاجِنَا
وَذُرِّيَّاتِنَا، وَتُبْ عَلَيْنَا اِنَّكَ اَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيْمُ، وَاجْعَلْنَا شَاكِرِيْنَ
لِنِعْمَتِكَ مُشْنِيْنَ بِهَا قَابِلِيْهَا وَاتِمِّمَهَا عَلَيْنَا

O Allah! Na bashko zemrat në mirësi! Na pajto! Na udhëzo në rrugën e paqes! Na liro nga errësirat për të shkuar drejt dritës! Na shpëto nga ligësitë, sherret dhe çrregullimet, të hapëta apo të fshehta! Na beko dëgjimin, shikimin, zemrat, bashkëshortët, fëmijët dhe na prano pendimin me mëshirë! Ti je me të vërtetë Pendimpranuesi, Mëshirëploti. Na bëj mirënjohës të Tu për bekimin Tënd dhe na mundëso ta vlerësojmë bekimin Tënd siç duhet, ta përvetësojmë atë dhe Ti Vetë plotësoje atë për ne!

Ebu Daud, Kitabus-salat, bab teshehud.

Ramazani
shtatë dobite e agjërimit

Atif Rashid

Agjërimi gjatë muajit të bekuar të Ramazanit sjell më vete shumë dobi. Në këtë artikull do të nënvizoj vetëm shtatë prej tyre për të dhënë një aromë të bukurive të Ramazanit. “Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj”.¹

Muaji Ramazan erdhi edhe njëherë tek ne. Është muaji që përmban natën e bekuar që përshkruhet si nata më e bukur se një mijë muaj dhe është muaji në të cilin shejtani mbyllet në pranga dhe dyert e xhenetit hapen për kërkuarit e së vërtetës.

Kurani i Shenjtë paraqet qëllimin kryesor të muajit të agjërimit që është të përvetësojmë druajtjen e devotshmërinë. Nuk është e lehtë për t’u bërë i devotshëm dhe kështu që Ramazani është një periudhë ku veprat e mira bëhen me lehtësi dhe bekimet qiellore bëhen të kapshme. Për më shumë kualitete të caktuara të cilat ndikojnë pozitivisht në devotshmërinë e njeriut bëhen të mundshme.

1. Disiplina

Islam do të thotë nënshtrim i plotë ndaj vullnetit të Zotit e cila na drejton tek paqja. Nënshtrimi i plotë sidoqoftë nuk mund të arrihet pa disiplinë dhe bindje. Në këtë muaj, muslimanët urdhërohen të braktisin ushqimin, të zgjohen herët, të heqin dorë nga bisedat ose sjelljet e pahijshme dhe të përpiqen për t’u



përmirësuar dhe të përparojnë në bërjen e veprave të mira. Kjo kërkon disiplinë e cila arrihet duke e shtyrë vetën të zgjohet herët (ose në pjesën e fundit të natës), duke e sakrifikuar kënaqësinë e gjumit për t’u falur.

Disiplina nuk është diçka që mund të arrihet për një ditë ose edhe për një javë kjo është pse muslimanët urdhërohen të agjërojnë për një muaj të tërë.

2. Pastërtia

Muslimanët mësohen të marrin abdes para çdo namazi dhe të jenë në gjendje të pastër sa më shumë të jetë e mundur për shkak se pastërtia e jashtme ndikon



në pastërtinë e brendshme. Kjo është arsyeja pse Profeti Muhammed ^{S.A.V.S.} kishte thënë se pastërtia është gjysma e besimit. Kurani Famëllartë thotë:

“Vërtet, i shpëtuar është ai i cili e pastron vetveten”.²

Është vërtetuar shkencërisht se agjërimi pastron trupin nga helmet dhe duke braktisur ushqimin për një kohë, trupi ndihmohet në riparimin e qelizave dhe në përdorimin e energjisë në disa pjesë të tjera të trupit. Trupi gjithashtu djeg yndyrën për të prodhuar energji e cila çon deri te humbja e peshës.

Sipas NHS-së: “Pas disa ditëve të agjërimit, shihet prani e lartë e endorfinës në gjak, duke u bërë juve më vigjilent dhe duke u dhënë një ndjenjë të përgjithshme të rehatisë mendore”. Padyshim, siç ushqimi ndikon fuqimisht në trurin dhe emocionet tona, agjërimi ndihmon në pastrimin e papastërtive dhe ky detoksifikim rezulton me një ndjenjë të përgjithshme të rehatisë. Kjo arrihet nëse është bërë drejt edhe duke e mbajtur në balancë dietën gjatë ditëve të Ramazanit.

3. Vetëkontrolli

Kurani i Shenjtë thotë:

“Dhe ata që e përpijnë zemërimin dhe falin, Allahu i do mirëbërësit”.³

Njeriu nxitet e tundohet nga faktorë të ndryshëm si njerëzit, përgjegjësitë, mendimet, emocionet e ndryshme në jetën e tij etj., të cilat ia bëjnë të vështirë t'i kontrollojë veprimet e tij. Shumë njerëz

mundohen shumë për të hequr dorë nga ushqime të caktuara, zakone dhe praktika të shfrenuara por dështojnë, vazhdimisht. Ramazani dhe agjërimi ndihmojnë njeriun të edukojë ndjenjën e vetëkontrollit dhe të vigjilencës të cilat e bëjnë më të lehtë të heqë dorë nga zakonet e tij të këqija gjatë këtij muaji. Duke hequr dorë nga ushqimi, i cili është i lejuar dhe esencial për ekzistencën e njeriut, ai e forcon vendosmërinë dhe i mundësohet të ketë vetëkontroll më të madh ndaj veprimeve të tij. Diçka që i sjell atij dobi edhe jashtë Ramazanit.

4. Spiritualiteti



Ne mësojmë përmes ngjarjeve të njerëzve të shenjtë të kaluar se agjërimi promovon dhe rrit spiritualitetin e njeriut. Ata pajisen me aftësinë për të qenë në gjendje të përjetojnë vizione dhe fenomene të tjera shpirtërore të cilat të tjerët nuk mund t'i arrijnë. Kjo është arsyeja që profetët dhe njerëzit e Zotit shkonin të rrinin në vetmi për një kohë dhe jetonin në mënyrë të thjeshtë për të zhvilluar aftësitë e tyre shpirtërore.

Ramazani për muslimanët është e njëjta mënyrë e trajnimit shpirtëror e dizajnuar për të mprehur ndjenjat shpirtërore. Për më tepër, kjo arrihet edhe duke u fokusuar në recitimin dhe kuptimin e Kuranit të Shenjtë, zbritja e të cilit filloi pikërisht gjatë këtij muaji të bekuar të Profeti Muhammed ^{s.a.v.s.} dhe ishte kompletuar brenda periudhës 23 vjeçare.

5. Përlësia

“Vërtet, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, dhe përulen para Zotit të tyre, janë prej banorëve të xhenetit ku do të jetojnë përgjithmonë”.⁴



Muslimanët urdhërohen t'i dorëzohen Zotit dhe t'i nënshtrohen përlësisht vullnetit të Tij, duke mos qenë mosmirënjohës ndaj asaj që na dhuron e as të pabindur ndaj urdhrave të Tij. Arsyeja e të qenët të tillë është se ne nuk jemi më shumë se nevojtarë dhe shërbëtorë para Krijuesit dhe Mbretit të universit.

“O njerëz, ju jeni nevojtarë ndaj Allahut, kurse Allahu është i Vetëmjaftueshmi, i

Lavdëruari”.⁵

Agjërimi në muajin Ramazan na përkujton se jemi plotësisht të varur nga Zoti dhe kërkojmë vetëm nga Ai për të na ushqyer dhe siguruar sepse Ai është Siguruesi më i mirë. Kjo ia rrit njeriut përlësinë gjithashtu edhe mbështetjen në Zotin, gjë që i mundëson të fitojë afërsinë me Zotin.

6. Asgjësimi i egos së njeriut

Asgjësimi i egos ose “fenā” do të thotë të liruarit e plotë nga dëshirat, pasionet, shpresat dhe ambiciet dhe të liruarit nga të gjitha mendimet e vetvetes në rrugën e Zotit. Kur njeriu e pastron vetveten ai arrin në shkallën e të liruarit nga pikëllimi dhe frika dhe vazhdon progresin e tij në rrugën e Zotit.

“Dëgjoni! Miqtë e Allahut me siguri nuk do të kenë as frikë e as nuk do të pikëllohen”.⁶

Agjërimi dhe sakrifica janë mjete për të arritur në shkallën e vetëmohimit, sepse ne jo vetëm që nuk do të udhëhiqemi nga egoja jonë, dëshirat dhe motivet tona egoiste, por do t'i përshtatemi tërësisht vullnetit të Zotit dhe do të veprojmë ashtu siç dëshiron Ai deri në masën që ne të hamë, të flemë dhe të zgjohemi në përputhje me udhëzimin e Tij. Kur njeriu e arrin këtë dhe motivet ose qëllimet e tij nuk janë të prishura nga lakmia dhe materializmi, ai gëzon afërsinë me Zotin dhe kështu vazhdon udhëtimin e tij në drejtim të Zotit pafundësisht.

7. Dhembshuria

“Dhe ata i ushqejnë, nga dashuria për Zotin, të varfrit, jetimët, dhe të robëruarit”.⁷

Dyshim i vogël që mbetet është se njeriu nuk mund të kuptojë plotësisht një fenomen të caktuar derisa nuk e ka përjeton vetë. Kështu agjërimi i ndihmon muslimanët të kuptojnë ndjenjën e mungesës së ushqimit, përjetimin e vështirësive dhe të dhimbjes së atyre që janë nevojtarë por që jetojnë në shoqërinë e tyre. Në këtë mënyrë agjërimi synon të zhvillojë fuqimisht dhembshurinë për njerëzit e



tjerë. Kjo pa dyshim i nxit besimtarët për të bërë përpjekje humanitare duke ngritur



të shtypurit e jo t'i shohin me përçmim, siç bëjnë një pjesë e madhe e të pasurve sot në botë.

Prandaj, agjërimi është një pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme në besimin Islam dhe ka shumë dobi të cilat mund të arrihen vetëm nga ai që i përmbush kërkesat e Ramazanit me zell dhe kujdes të madh.

Zoti na mundësoftë të veprojme sipas këtyre pikave! Amin!

(E përktheu nga anglishtja:
Shkëlqim Bytyçi)

Burimi: <http://theviewpoint.co/ramadan-special-seven-benefits-of-fasting/>

1 Kurani Famëlartë 97:4.

2 Kurani Famëlartë 87:15.

3 Kurani Famëlartë 3:135.

4 Kurani Famëlartë 11:24.

5 Kurani Famëlartë 35:16.

6 Kurani Famëlartë 10:63.

7 Kurani Famëlartë 76:9.

Lutje për të shpëtuar nga mosagjërimi në muajin e ramazanit

*Duke këshilluar për lutje për të pasur mundësinë e agjërimit,
Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:*

Çdo gjë dubet t'ia kërkonit Zotit të Madhërishëm. Ai është i Plotfuqishëm absolut dhe nëse do, mund të mundësojë edhe një të sëmurë me temperaturë që të agjërojë. Prandaj, sipas meje, ai që nuk agjëron dot, le të lutet:

O Zoti im! Ky është muaji Yt i bekuar dhe unë mbetem i privuar nga ky. Kushedi nëse vitin e ardhshëm do të jem i gjallë apo jo, a do të mund të plotësoj agjërimet që nuk po agjëroj apo jo?!

Personi i tillë, nëse do t'i kërkojë mundësi Zotit, jam i bindur që Zoti i Madhërishëm do t'i japë forcë atij.

E MIRA DHE E KEQJA

*Hazret Mirza Masrur Ahmed, Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar
Allahu e ndihmoftë fuqimisht!*



Përkthim në shqip i fjalimit të xhumasë së mbajtur nga Hazret Mirza Masrur Ahmed, Kalifi i Pestë i Mesihut të Premtuar (Udhëheqësi botëror i Xhematit Musliman Ahmedia), më 11.03.2016 në xhaminë Bejtul Futuh të Londrës

Pas recitimit të *tesbehudit*, të *tesmijes* dhe të sures El-Fatiha, Huzuri recitoi ajetin vijues të Kuranit Famëlartë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّبِعُوا خُطُوبَ
الشَّيْطَانِ ۚ وَمَنْ يَتَّبِعْ خُطُوبَ الشَّيْطَانِ
فَإِنَّهُ يَأْمُرُ بِالْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَلَوْلَا
فَضْلُ اللَّهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ مَا زَكَا
مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ أَبَدًا وَلَكِنَّ اللَّهَ يُزَكِّي
مَنْ يَشَاءُ ۚ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٥٠﴾

Përkthimi i këtij ajeti është:

“O ju që besuat! Mos ndiqni hapat e shejtanit. Kushdo që i ndjek hapat e shejtanit (le ta dijë se) ai, pa dyshim, urdhëron për të pahijshmet dhe të ndaluarat. Sikur të mos kishit bekimin e Allahut mbi vete dhe mëshirën e Tij, askush nga ju nuk do të mund të pastrohej kurrë. Por Allahu pastron kë të dojë. Allahu është Dëgjues, i Dijshëm”.
(Kurani Famëlartë 24:22)

Cfarë janë hapat e shejtanit dhe si mund të ruhemi nga ata?

Shejtani është armiku i njeriut që prej

fillimit dhe do të vijojë të jetë i tillë. Kjo nuk është sepse ai ka ndonjë fuqi që të qëndrojë përgjithmonë, por për shkak se Zoti i Madhërishëm, kur e krijoi njeriun, atij i dha liri, sepse Zoti i Madhërishëm e dinte që robërit e Tij do të jenë të mbrojtur nga shejtani. Armiqësia e shejtanit nuk është ndonjë armi qësi e hapët, në kuptimin që ai ta sfidojë njeriun duke i qëndruar ballë për ballë, por përkundrazi. Ai nxit egon e njeriut duke përdorur mënyra e mashtrime të ndryshme dhe duke i treguar ëndrra lakmuese të kësaj bote. Në këtë mënyrë, ai e largon njeriun nga mirësitë dhe e shpie në të këqijat.

Shejtani kishte pohuar para Zotit të Madhërishëm duke thënë: ngaqë Ti e ke krijuar njeriun me natyrën që ai di t'i zgjedhë të dyja drejtimet, unë do ta bëj atë që të ngjitet pas meje, sepse ai do të anojë më shumë nga e keqja; nëse më lejon, do ta sulmoj dhe do ta tundoj atë në çdo rrugë dhe shumica e njerëzve do të ndjekin hapat e mi, përveç robërve të Tu të vërtetë, të sinqertë, të cilët do të jenë të mbrojtur nga sulmet e mia, sepse ata me asnjë lloj sulmi nuk do t'i dëmtoj dot. Zoti i Madhërishëm e lejoi të vepronte në këtë mënyrë dhe njëherësh pohoi: Kushdo që do të të ndjekë ty, do të përfundojë në xhehenem.

Megjithatë, Zoti i Madhërishëm ua bëri të qartë njerëzve rrugën e mirësive, duke dërguar profetët e Tij. Ua tregoi edhe metodat e përmirësimit, edhe mënyrat



sesi ata mund të zbukurojnë botën dhe ahiretin e tyre dhe, gjithashtu, ua bëri të qartë - djalli është armiku juaj i hapët, i cili do t'ju vijë si këshilltar e dashamirës dhe do t'ju thotë se po ju sjell dobi, por në realitet ai do t'ju thërrasë në humbje. E kur do të vijë koha për të dhënë llogari, shejtani lirisht do t'u thotë njerëzve: “Është e vërtetë që ju kam ftuar për të bërë mëkate dhe për të kundërshtuar porositë e Zotit të Madhërishëm, por ju keni pasur mendje. Pse nuk e përdorët? Pse i keni dhënë përparësi thirrjes sime për të hyrë në mëkate, mbi thirrjen e Zotit të Madhërishëm, i cili ju porosiste për mirësi e bamirësi. Prandaj, sot shijojeni atë që keni bërë! Unë nuk kam asnjë lidhje me ju. Unë e kisha si qëllim që të bëja rolin e armiqësisë me ju. Digjuni tash në zjarrin e xhehenemit!” Kështu, pra, djalli bën armiqësi me njeriun. Allahu i Madhërishëm në

shumë ajete të Kuranit Famëlartë na alarmoi për sulmet dhe mashtrimet e shejtanit. Pikërisht këtë e thotë Allahu i Madhërishëm edhe në ajetin që recitova në fillim. Zoti tha se djalli nuk e lë njeriun të lirë. Për sa kohë që ai i tha Zotit: “do t'i vij njeriut nga e djathta dhe nga e majta, nga para dhe nga mbrapa”, ai kështu do të vepronte, pa pushim. Madje, shejtani gjithashtu pohoi “do të qëndroj në rrugën e drejtë për ta sulmuar njeriun”. Dikush mund të mendojë – jam në rrugën e drejtë dhe do të jem i shpëtuar nga sulmet e shejtanit. Por, ky mendim i tij është thjesht një imagjinatë. Ata që morën zemërimin e Allahut të Madhërishëm si dhe ata që u quajtën “te devijuar” (*dālīn*), më parë ishin në rrugën e drejtë, ishin ndjekës të Hazret Musait a.s., ishin ndjekës të Hazret Isait a.s., e megjithatë, ranë në *shirk* dhe humbje. Të njëjtët u bënë

mohues të Profetit Muhammed ^{S.A.V.S.}.

Andaj, Zoti i Madhërishëm tha se shejtani nuk i largohet njeriut, edhe kur ky i fundit bëhet besimtar, madje vijon ta largojë atë nga rruga e drejtë. Shumë njerëz, pasi e pranojnë besimin, bëhen pre e mashtrimeve të shejtanit, madje, edhe ata që e quajnë veten muslimanë, nganjëherë bëhen të padëgjueshëm dhe kthehen nga besimi. Shkurt, ky është një rrezik shumë i madh që i kanoset njeriut nga shejtani. Vetëm mirësia e veçantë e Zotit të Madhërishëm mund ta shpëtojë njeriun nga ai, dhe Ai me të vërtetë e shpëton.

Edhe në këtë ajet, në pjesën e fundit të tij, Zoti i Madhërishëm i qetësoi besimtarët me dy fjalë: **“Ai është Dëgjues dhe i Dijshëm”**. Allahu është *Semî*, që do të thotë se Ai dëgjon shumë. Për këtë arsye, Atij duhet t’ia trokisni derën. Atë duhet ta thërrisni dhe ta thërrisni me qëndrueshmëri. Pranë Tij duhet të përkuleni e të bëni lutje në mënyrë të vijueshme. Ai Zot është edhe i Dijshëm, pra, i njeh mirë gjendjet e robërve të Tij. Kur Ai do të vërejë se robi i Tij po e thërret me sinqeritet të plotë, do t’i dhurojë një forcë të tillë besimi, e cila do ta mbrojë atë nga sulmet e shejtanit. Më pas, ai do të gjejë mundësi për t’u ngritur lart e më lart në mirësi dhe do të gjejë edhe forcën për t’u mbrojtur nga të këqijat.

Për sa kohë që shejtani i kishte pohuar Zotit: “Përveç robërve të Tu të sinqertë,

të gjithë do të më ndjekin mua”, një njeri i mençur patjetër që do t’i thërrasë mendjes. Besimtari i vërtetë ka nevojë të mendojë se si mund të bëhet i sinqertë. Zoti i Madhërishëm po në këtë ajet tregon një recetë, e cila e bën besimtarin të sinqertë. Zoti thotë: Ruhu nga çdo gjë që është e pahijshme dhe e ndaluar dhe që është e papëlqyeshme te Zoti! Ai që e bën këtë, mëshira e Zotit do ta pastrojë atë dhe vetëm i tilli do të jetë i pastër. Atij nuk mund t’i afrohet më shejtani.

Strategjia e shejtanit

Një gjë tjetër që duhet ta kemi parasysh është që sulmi i shejtanit nuk bëhet i menjëhershëm. Ai e sulmon njeriun ngadalë-ngadalë. Ai mbjell një të keqe të vogël në zemrën e tij dhe e bind që nuk ka të keqe nga diçka kaq e vogël, pasi ajo nuk përbën mëkat. Por, pikërisht këto gjynahe të vogla shkaktojnë gjynahe të mëdha. Gjithashtu, duhet ditur se gjynahet e mëdha nuk janë vetëm rrëmbimi, vjedhja, vrasja etj., por çdo ligësi që kërcënon paqen dhe qetësinë e shoqërisë është një gjynah i madh. Njeriu kur këmbëngul në veprimet e tij të liga, ai e humb ndërgjegjen se çfarë është duke bërë.

Andaj, Allahu i Lartësuar thotë se nëse doni të jeni të pastër, nëse doni të keni pëlqimin Tim, ju duhet t’u shmangeni vijueshmërisht ligësive dhe hapave të djallit në njërën anë, dhe në anën tjetër,



vijueshmërisht duhet të vini në mbrojtjen e Allahut të Lartësuar dhe të përpiqeni të jeni të pastër dhe vijueshmërisht keni nevojë ta thërrisni Atë për ndihmë. Pa e bërë këtë, nuk mund t'u shpëtoni dot sulmeve të shejtanit.

Zoti pse e ka krijuar shejtanin?

Në vijim, do t'ju sjell disa citate nga shkrimet e Hazret Mesihut të Premtuar^{a.s.}. Disa njerëz pyesin ose u lind pyetje në zemër se Zoti pse e ka krijuar shejtanin? Përse vallë nuk e ka asgjësuar që ditën e parë, kur ai bëri shkelje? A nuk do të merrnin fund të gjitha të këqijat, nëse do ta asgjësonte atë që ditën e parë? Duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. në një vend thotë:

“Çdokush e pranon se njeriu ka dy tërheqje në natyrën e tij: njëra që tërheq drejt hairit, drejt së mirës dhe tjetra drejt sherrit, drejt së keqes. Në përgjithësi, të gjithë e ndiejnë këtë fenomen, që, kur njeriut i lindin mendime të këqija, ai anon kaq fort nga e keqja, i duket sikur dikush e tërheq drejt saj. Po ashtu, nganjëherë i lindin mendime për të bërë të mira dhe ai anon kaq shumë nga ato, sa që ndien sikur dikush a diçka po e tërheq drejt së mirës. Nganjëherë njeriu bën një gjynah dhe më pas pendohet thellë dhe anon nga e mira. Nganjëherë ndodh që ai shan ose rreh dikë dhe më pas pendohet për veprimin e tij dhe për ta shlyer gabimin, i bën ndonjë të mirë ose i kërkon falje.

Shkurt, të dyja këto tërheqje ekzistojnë në qenien njerëzore. Libri i Islamit forcën e së mirës e ka quajtur inspirim prej engjëlli, kurse forcën e së keqes ... e ka quajtur inspirim prej djallit. ... Filozofët e kanë pranuar këtë fakt vetëm deri tek ekzistenca e tyre në qenien njerëzore, por Zoti që zbulon sekretet më misterioze, që e informon njeriun për çështjet shumë të imëta, të dyja këto forca i ka quajtur krijesa. Forcën që inspiron për të mirën, e ka quajtur *engjëll* dhe *shpirt të shenjtë*, kurse forcën që inspiron për të keqen e ka quajtur *shejtan* dhe *iblis*. ... Filozofët e moçëm e të mençur e kanë pranuar faktin se çështja e inspirimeve nuk është e kotë dhe e pakuptimtë”.

Hazret Mesihu i Premtuar a.s. më tutje thotë:

“Këto dy forca të qenies njerëzore, të cilat daç i quani forca, daç i quani si shpirt të shenjtë dhe djall, përkatësisht, por që nuk i mohoni dot, janë krijuar me qëllim që njeriu të shpërblehet për veprat e tij të mira. Ai po të ishte i detyruar të bënte vetëm veprat e mira dhe nuk do të kishte mundësi të bënte të kundërtën, nuk do të fitonte ndonjë shpërblim aspak. Por në çastin kur ai gjendet midis dy tërheqjeve dhe e zgjedh tërheqjen e së mirës për t’iu bindur, vlerësohet për t’u shpërblyer për veprën e tij.

... Kështu që, nuk mund të vihet në dyshim se njeriu ndien dy lloj inspirimesh në zemrën e tij, atë të së mirës dhe të së keqes. Por për sa kohë që ato e kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe për sa kohë që njeriu vetë nuk i zotëron dot, kuptohet që ato i vijnë nga jashtë dhe përsosmëria e njeriut varet nga ato. Është interesante që të dyja qeniet që përmendëm, pra, engjëllin dhe djallin, i pranojnë edhe librat e hinduve, i pranojnë edhe ata që adhurojnë zjarrin, madje të gjithë librat që kanë ardhur prej Zotit, e pranojnë ekzistencën e tyre. Nëse dikush prapë kundërshton, kundërshton thjesht nga padituria dhe inati.

Duhet shtuar se ai që nuk heq dorë nga ligësia dhe keqbërja, bëhet djalli vetë. Siç e thotë Zoti në një ajet të Kuranit se edhe njerëzit nganjëherë shndërrohen

në djaj. Atëherë, përse nuk i ndëshkon Zoti? Përgjigjja është që Kurani Famëlartë ka përmendur një ditë të caktuar për ndëshkimin e shejtanit, andaj duhet ta prisni ditën e premtuar. Shumë djaj janë ndëshkuar nga dora e Zotit deri më tani dhe shumë të tjerë do të ndëshkohen”.

(*“Çeshma-e-Ma’rifet”, “Rubani Khazain”, vëll. 23, f. 293-294*)

Duke treguar se cilat janë gjërat, drejt të cilave shejtani e fton njeriun dhe cilët janë njerëzit që ndjekin hapat e shejtanit dhe cilat janë mjetet, nëpërmjet të cilave, njeriu mund të largohet nga hapat e shejtanit, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Shejtani thërret dhe fton drejt gënjeshtërisë, padrejtësisë, mizorisë, euforisë, zvarritjes, dukjes dhe arrogancës. Karshi tyre, Allahu i Madhërishëm fton drejt virtyteve të larta si durimi, përqendrimi, asgjësimi i *nefsit* për Allahun, sinqeriteti, besimi, shpëtimi. Njeriu gjendet midis këtyre dy tërheqjeve. Ai që ka natyrën e pastër dhe farën e fatbardhësisë, falë bekimit të kësaj fare, vrapon drejt Allahut të Madhërishëm, pavarësisht nga prania e një mijë ftesave dhe tundimeve të shejtanit, sepse qetësinë dhe kënaqësinë e tij shpirtërore, ai e gjen vetëm te Zoti”.

Hazret Mesihu i Premtuar a.s. vijon:

“Çdo gjë ka disa shenja të ekzistencës së saj. Derisa nuk dallohen shenjat e diçkaje të caktuar, ajo nuk mund të



jetë e besueshme. Vini re se si mjekët i dallojnë ilaçet. ... Ato po të mos i kishin efektet e tyre, të cilat mjekët i kanë njohur pas një përvoje të gjatë, nuk do të çmoheshin nga mjekët. Po kështu ekzistojnë shenjat e besimit, të cilat Zoti i Madhërishëm, në mënyrë të përsëritur i ka përmendur në librin e Tij.

Është plotësisht e vërtetë që në momentin që hyn besimi në shpirtin e njeriut, do të hyjnë edhe madhështia e Zotit, shenjtëria e Tij, mrekullibërja e Tij dhe mbi të gjitha do të hyjë në të edhe kuptimi i vërtetë i pohimit “nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut”. Kështu vijon të ndodhë, derisa Zoti i Madhërishëm e merr si vendqëndrim qenien e tij, kurse jeta e tij satanike dhe natyra e tij për të bërë gjynahe pësojnë një vdekje”.

Kjo është pikërisht ajo fatbardhësi e natyrës njerëzore e cila, duke u bashkuar

me besimin e vërtetë, arrin t’ia asgjësojë vetinë e të mëkatuarit. Hazret Mesihu i Premtuar a.s. vijon:

“Atëherë njeriu fillon një jetë të re, e cila do të jetë shpirtërore. Ose me fjalë të tjera, mund të thuash se ajo do të jetë dita e parë e lindjes së tij në qiell. Kur jeta satanike pëson vdekje, lind jeta shpirtërore”.

(*“Malfuzat”, vëll. 2, Angli, 1985, f. 169*)

Kjo pikërisht është koha kur njeriu bëhet i Zotit të Madhërishëm.

Dallimi midis gjynahut të Ademit dhe atij të shejtanit

Duke treguar lidhjen e arrogancës dhe të shejtanit, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Edhe Ademi kishte bërë gjynah, që ishte gjynahu i parë dhe, edhe shejtani kishte bërë gjynah. Por Ademi nuk kishte mendjemadhësi dhe për këtë

arsye, ai e pranoi fajin para Zotit të Madhërishëm dhe atij iu fal gjynahu. Nga kjo shpresohet se njeriut mund t'i falen gjynahet përmes pendesës".

Nëse njeriu nuk ka mendjemadhësi, nëse i pranon gjynahet, nëse pendohet, nëse i kërkon falje Zotit të Madhërishëm, atëherë i falen gjynahet.

"Por shejtani u tregua mendjemadh dhe për këtë arsye, u quajt i mallkuar. Njeriu nuk e zotëron këtë gjë. Mendjemadhi më kot ngrihet për të bërë pretendime të paqena".

Sepse, njeriu nuk ka kaq shumë forcë që ai të tregohet arrogant. Deri ku mund të shkojë ai? Mesihu i Premtuar a.s. thotë se njeriu mendjemadh më kot pretendon të posedojë diçka që nuk e ka. Ai vijon:

"Profetët kanë shumë aftësi dhe njëra prej tyre është që ata arrin ta mposhtin egon e vet. Ata sjellin një vdekje mbi *nefsin* e tyre, duke e mohuar vetveten tërësisht. Krenaria i përket Zotit. Ata që nuk tregohen mendjemëdhenj, madje tregohen të përlulur, nuk shkatërrohen".

(*"Malfuzat"*, vëll. 9, Angli, 1985, f. 281)

Prandaj, ruhuni nga mendjemadhësia! Kjo është vetia që besimtari duhet ta përvetësojë, përndryshe ai ecën pas hapave të shejtanit. Nganjëherë njeriu nuk e ndien mendjemadhësinë e vet, prandaj është e nevojshme që në mënyrë shumë të thellë të analizojmë veten tonë.

Duke folur se në sa shumë mënyra

shejtani tenton të bëjë zap njeriun, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

"Nëse njeriu heq dorë nga veprat që përbëjnë gjynahe, shejtani përpiket të qëndrojë të paktën në sytë e tij, në veshët e tij dhe në hundën e tij. Kur nuk e zë dot vendin edhe atje, ai përpiket të qëndrojë të paktën në zemrën e tij".

Disa njerëz nuk bëjnë gjynahe të dukshme, as të mëdha e as të vogla. Disa njerëz nuk kanë mundësi të bëjnë gjynahe ose nuk i bëjnë për shkak të frikës, prapëseprapë, shejtani dëshiron ta mbajë gjallë farën e mëkatit në zemrat e tyre. Hazret Mesihu i Premtuar a.s. vijon:

"Me fjalë të tjera, shejtani e çon deri në fund betejën e tij. Por, ai nuk mund të mbretërojë në zemrën në të cilën ekziston frika ndaj Zotit. Atje shejtani dëshpërohet më në fund, sepse dështon në planin e tij për të parë veten madhështor. Atëherë detyrohet të braktiset nga atje duke marrë të gjitha plaçkat e tij".

(*"Malfuzat"*, vëll. 3, Angli, 1985, f. 401-402)

Kështu që, gjëja më e rëndësishme është që njeriu të ketë në zemër frikë ndaj Zotit. Nëse do ta ketë atë, ai mund të ruhet nga shumë mëkate. Vjedhësi vjedh. Por edhe ai, gjatë vjedhjes, nëse është në dijeni se një fëmijë është duke e parë atë, do të ketë frikë nga fëmija. Prandaj, derisa nuk kemi besim gjatë gjithë kohës se Zoti na sheh çdo veprë



që bëjmë, ne nuk mund të shpëtojmë dot nga gjynahet.

Dallimi midis fjalëve të nefsit, të shejtanit dhe atyre që vijnë prej Zotit

Komentim i sures En-Nas

Disa herë shejtani e nis punën e tij duke prurë mendime të mira në zemrën e njeriut. Njëherë, në një mbledhje me Hazret Mesihun e Premtuar a.s., po diskutohej se disa njerëz nuk arrijnë të dallojnë fjalët e *nefsit*, inspirimin e shejtanit nga shpallja (*ilhami*) e Zotit. Në lidhje me këtë, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Disa njerëz nuk e bëjnë dot dallimin midis fjalëve të *nefsit*, frymëzimit të shejtanit dhe *ilhamëve* (shpalljeve) që

vijnë nga Zoti. Ajo që vjen prej Zotit është madhështore, e ëmbël, të godet në zemër, ajo është një fjalë që lëshohet nga gishtat e Zotit dhe ngulitet drejt e në shpirt aq fort, saqë asgjë nuk mund të barazohet me të në peshë. Siç e thotë Zoti në Kuranin Famëlartë:

إِنَّا سَنُلْقِي عَلَيْكَ قَوْلًا ثَقِيلًا ۝

“Ne së shpejti do të të dërgojmë ty një fjalë me peshë”. (*Kurani Famëlartë* 73:6) Fjala “*thakil*” (me peshë) këtë kuptim e ka. Kurse frymëzimi që vjen nga shejtani nuk e ka këtë cilësi. Fjalët e nefsit dhe ato të shejtanit njëllon janë. Njeriu ka dy forca që janë të lidhura me jetën e tij. Njëra është engjëllore dhe tjetra satanike. Si të thuash, këmbët e tij janë të lidhura me dy litarë. Engjëlli e nxit dhe e ndihmon njeriun të bëjë mirësi, siç e thotë Kurani: **وَالَّذِينَ يُؤْتُونَ مَالَهُمْ** “Ai i ndihmoi duke dërguar fjalën e Tij”.

(Kurani Famëlartë 58:23)

Kurse shejtani e fton drejt ligësisë. Siç e thotë Kurani: “*Ju vesvisu*” (ai pëshpërit).

(Kurani Famëlartë 114:6)

Pra, nuk mund të mohohen këto dy forca. Njeriut i shoqëron edhe errësira, edhe drita. Mosdija rreth diçkaje të caktuar, nuk përbën argument për mosekzistencën e saj. Madje, përveç kësaj bote (që ka njohur njeriu), Zoti ka bërë edhe mijëra mrekulli të tjera. Zoti na mëson: **قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ** “Kërkoj mbrojtjen e Zotit të njerëzve;” (Kurani Famëlartë 114:2)

Ky ajet flet për ato pëshpëritjet e shejtanit, të cilat ai i bën me njerëzit këto ditë”.

Sidomos në këtë kohë, e cila është një epokë e zhvillimit material, në të cilën njeriu po e harron Zotin. Hazret Mesihu i Premtuar a.s. vijon:

“Pëshpëritja e tij më e rëndë është ajo që shkakton keqkuptime në lidhje me Krijuesin. Siç vërejmë që njeriu kur sheh pasuri të bollshme te tjetri, atë e kujton si Mbajtës. ... Për këtë arsye, Kurani na mësoi të kërkojmë mbrojtjen e Zotit të vërtetë të njerëzve.

Pastaj, njeriu mendon se mbretërit dhe pushtetarët e kësaj bote e kanë kontrollin dhe sundimin absolut dhe për këtë na vjen kjo lutje: **مَلِكِ النَّاسِ** “*Melikin-nas*”, “Kërkoj mbrojtjen e Sunduesit të njerëzve”,

dhe na është bërë me dije që Sunduesi i vërtetë i njerëzve është Zoti.

Pëshpëritjet e shejtanit vijnë dhe i

bëjnë njerëzit që krijesat t'i marrin për Zot dhe prej tyre lidhin frikën dhe shpresën e tyre. Për këtë arsye, lutja e radhës është: **إِلَهِ النَّاسِ** “*Ilahin-nas*”, “Kërkoj mbrojtjen e të Adhuruarit të njerëzve”.

Me një fjalë, ka tri lloj pëshpëritjesh të këqija dhe, në suren En-nas, Zoti na jep tri mbrojtje kundër tyre. Shkaktari i këtyre pëshpëritjeve është pikërisht “*hen-nasi*”, pra, shejtani, i cili në gjuhën hebraike quhet “*nehash*”, që i ishte afruar Evës. Sipas emrit të tij, ai bën sulme të fshehta. Për të flitet edhe në suren En-Nas. Kjo tregon se edhe Dexhalli nuk do të bëjë forcë, por do të sulmojë fshehtas, në mënyrë që askush të mos marrë vesh se çfarë po ndodh”.

Shkëlqimi i botës së sotme, shpikjet nga më të rejat e sotshme, përpjekjet nën petkun e shkencës për ta larguar njeriun nga Zoti dhe nga kërkimi i Tij, të gjitha këto janë mjetet e Dexhallit. Këtu



përfshihen qeveri, organizata të mëdha dhe organizata për të drejtat e grave, të cilat, në emër të të drejtave të njeriut i devijojnë njerëzit duke u thënë: Kujdes! Feja ju privon nga këto gjëra, kurse është


e drejta juaj që ju të keni liri të plotë etj. Pra, këto janë masat e shejtanit që ai po i merr ngadalë-ngadalë. Sa herë që këto organizata që punojnë në emër të të drejtave të njeriut, të grave etj., punojnë për të larguar njeriun nga besimi në Zot, çdokush duhet të kuptojë, çdo besimtar dhe çdo ahmedian duhet të kuptojë se ai është një sulm i shejtanit dhe ai sulm po bëhet nga forcat e Dexhallit. Hazret Mesihu i Premtuar a.s. vijon:

“Nuk është e saktë që vetë shejtani i ka dalë hapur Evës, por i kishte dalë i maskuar, siç del sot i maskuar para njerëzve”.

Nuk ishte ndonjë qenie apo ndonjë person që i kishte dalë Evës, por ishte një pëshpëritje.

“Shejtani i inspiron pëshpëritjen e tij një njeriu dhe ai njeri bëhet zëvendës i tij. Pra, ai ia kishte inspiruar një kundërshtari të besimit fjalën e vet. Gjithashtu, edhe xheneti ku jetonte Ademi, nuk ishte diku tjetër në hapësirë, por këtu në Tokë. Një i lig i kishte cytur një dëshirë në zemrat e tyre.

Në suren e parë të Kuranit Famëlartë, Allahu i Madhërishëm i porositi myslimanët të mos bëhen si “ata që tërhoqën zemërim” dhe ata që “devijuan” ose me fjalë të tjera u tha myslimanëve: “O Muslimanë! Mos ndiqni rrugët e hebrenjve dhe të krishterëve!” Edhe kjo porosi përbën një profeci që do të vinin disa muslimanë, të cilët do të vepronin



në këtë mënyrë. Pra, do të vinte një kohë kur një pjesë e muslimanëve do t’u ngjanin hebrenjve dhe të krishterëve, sepse porosia lëshohet atëherë, kur ekziston edhe mundësia që ajo të mos zbatohet”.

(*“Malfuzat”, vëll. 2, Angli, 1985, f. 244-245*)

Përparësia e besimit mbi botën

Duke treguar se me çdo kusht besimit duhet t’i jepni përparësi mbi botën, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Shikoni se ka dy lloj njerëzish. Lloji i parë i tyre përfshin ata që e pranojnë Islamin, por prapëseprapë mbeten të mbërthyer në tregtitë e kësaj bote.



Shejtani u rri në krye. Nuk e kam fjalën që tregtia është e ndaluar. Absolutisht jo. Edhe sahabët e Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.} bënë tregti, por ata besimit i jepnin përparësi mbi botën. Ata kur e pranuan Islamin, fituan dijen e vërtetë rreth tij, një dije që ua mbushi zemrat me bindje. Kjo ishte arsyeja që ata nuk u lëkundën në asnjë betejë para sulmeve të shejtanit. Asgjë nuk i ndaloi dot nga pohimi i së vërtetës. E kam fjalën vetëm që ata që bëhen robër të kësaj bote, madje adhures të saj, djalli i mbizotëron dhe i bën zap.

Në llojin e dytë përfshihen ata, të cilët shqetësohen për përparimin e besimit. Ky grup i njerëzve është ai që quhet *“hizbullah”* (ushtria e Allahut) i

cili ngadhënjën mbi djallin dhe ushtrinë e tij. Paraja bëhet me tregti dhe përmes saj shtohet, për këtë arsye, Zoti i Madhërishëm edhe kërkimin e besimit dhe zhvillimin e tij e ka quajtur tregti. Siç Zoti i Madhërishëm thotë:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ ۚ آمَنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ عَلَىٰ
بَدَأَ يُذِيقَهُمْ قَوْلَ عَذَابٍ إِلَيْهِ ۝

“A t’ju njoftoj për një tregti, që do t’ju shpëtojë nga një ndëshkim i dhimbshëm?” (*Kurani Famëllartë* 61:11) Tregtia më e mirë është ajo që bëhet në besim, që të liron nga ndëshkimi i dhimbshëm. Prandaj, edhe unë me fjalët e Zotit do t’ju them:

“A t’ju njoftoj për një tregti, që do t’ju shpëtojë nga një ndëshkim i dhimbshëm?”

(*“Malfuzat”, vëll. 3, Angli, 1985, f. 193-194*)

Pra, tregtinë e tillë duhet ta bëjmë ne dhe duhet të ndjekim rrugët, për të cilat në thërret Imami i kohës, i caktuari i Allahut, Mesihu i Premtuar, Imam Mehdiu, në mënyrë që të ruhemi nga hapat e shejtanit dhe, duke fituar pëlqimin e Zotit, të ruhemi nga ndëshkimi i dhimbshëm.

Si të ruhemi nga mëkatet e fshehta?

Duke na tërhequr vëmendjen që të ruhemi nga mëkatet e fshehta, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

Kur dikush bie në vështirësi, faji më në fund del i robit, dhe jo i Zotit. Disa njerëz



në dukje mund të jenë shumë të dëlirë, dhe njeriu habitet se pse ata i goditi belaja ose pse ata u privuan nga mirësia, por në fshehtësi veprojnë edhe mëkatet e fshehura, të cilat ua shkatërrojnë jetën. Allahu i Madhërishëm ngaqë fal shumë dhe toleron shumë, nuk lejon që mëkatet e fshehta të njeriut të zbulohen. Por në të vërtetë, mëkatet e fshehta janë më të këqija sesa ato të hapëta. Edhe mëkatet janë si sëmundje. Sëmundjet kryesore i dallon çdokush, por ka disa sëmundje të fshehta, të cilat nganjëherë nuk i di as i sëmuri. Ka edhe sëmundje, të cilat as mjekët nuk i dallojnë dot në fillim, derisa ato nuk marrin përmasa të

mëdha”.

Nganjëherë kanceri dallohet në fazën e fundit. Njeriu duket krejt normal, por papritmas mjekët kuptojnë se nuk është më në dorën e tyre që ta kurojnë atë dhe brenda pak muajsh, ai vdes. Mesihu i Premtuar a.s. vijon:

“Ashtu siç disa sëmundje nuk kuptohen, nuk kuptohen as mëkatet e fshehta të njeriut, të cilat shkallazi e çojnë drejt shkatërrimit. Zoti i Madhërishëm na mëshiroftë me mirësinë e Tij! Kurani Famëlartë thotë: **فَاتْلَعْ مِنْ رُطْبَتِهَا** “Fitoi ai që e pastroi nefsin e tij”. (Kurani Famëlartë 91:10)

Por, edhe pastrimi i nefsit është një lloj

vdekjeje. Si mund ta pastrosh nefsin, derisa nuk heq dorë nga të gjitha veset?!” Të gjitha veset që shejtani dëshiron që ne t’i kemi, pra ato që përmenden edhe në ajetin në fjalë “*fahsha*” (të pahijshmet) dhe “*munkar*” (të ndaluarat), derisa nuk i largojmë nga vetja jonë, nuk mund ta pastrojmë nefsin tonë.

“Çdo njeri ka një farë të keqe dhe ajo është pikërisht shejtani i tij. Derisa ai nuk e vret atë, nuk ia del dot”.

(“*Malfuzat*”, vëll. 9, Angli, 1985, f. 280-281)

Siç ju thashë edhe më përpara, çdo çast ne duhet të kërkojmë mbrojtjen e Allahut dhe çdo çast duhet të bëjmë analizën tonë. Se çfarë masash duhet të marrim për ta shkatërruar shejtanin, në lidhje me këtë, Hazret Mesihu i Premtuar a.s. thotë:

“Të dërguarit vijnë si pasqyrë e njëshmërisë së Zotit dhe ata janë Zotrrëfyes. Muslimani i vërtetë dhe i devotshëm është ai që bëhet pasqyrë e të dërguarve. Sahabët e kishin kuptuar mirë këtë sekret dhe kaq shumë ishin të përhumbur pas bindjes ndaj të Dërguarit të Allahut ^{s.a.v.s.}, saqë kishin asgjësuar çdo gjë që i përkiste vetes së tyre. Kushdo që i shikonte, befasohej nga devotshmëria e tyre”.

Ata gjithnjë rrinin në kërkim të afrimit me Zotin dhe të përvetësimit të

modelit Profetit Muhammed ^{s.a.v.s.}.

“Prandaj, mbani mend! Edhe në këtë kohë, pretendimi juaj për të qenë ndjekës të sinqertë do të përligjet vetëm atëherë kur do ta keni të njëjtën devotshmëri, thellim dhe bindje që kanë pasur sahabët e Profetit ^{s.a.v.s.}. Mbajeni mend shumë mirë këtë që po ju them! Derisa Zoti i Madhërisëm nuk i merr si vendqëndrim qeniet tuaja, derisa nuk shfaqen shenjat e Tij në ju, pushteti i shejtanit do të vijojë të veprojë në ju”.

Lutje

Allahu na bëftë të përpigemi me sinqeritet të plotë për t’u bërë të Atij! Të ruhemi nga të gjitha të pahijshmet dhe të ndaluarat! Të ruhemi nga të gjitha llojet e të këqijave! Të ruhemi nga çdolloj krenarie a mburrjeje! Të vijojmë të përpigemi për të pastruar veten tonë, në mënyrë që të trashëgojmë bekimet e Zotit të Madhërisëm! Shikimi ynë gjithmonë të jetë drejt Zotit dhe vetëm Ai të mbetet Zoti ynë! Vetëm Sundimi i Tij të mbretërojë zemrat tona! Vetëm Ai të mbetet i Adhuruari ynë! Dhe ne gjithmonë Atë ta thërrasim, duke u ruajtur nga hapat e shejtanit! Allahu i Madhërisëm na mundësoftë të veprojmë në këtë mënyrë!



QËLLIMI I AGJËRIMIT

Shahid Ahmad

Agjërimi është një mjet për pastrimin dhe edukimin shpirtëror.

Njeriu duke hequr dorë nga disa prej kënaqësive të tij për hir të Zotit, mëson sesi t'u përmbahet veprave fisnike dhe virtyteve të larta, dhe t'i shmanget çdo gjëje të ndaluar dhe të ndyrë.

Duke obliguar agjërimin, Allahu na tregon dobitë e tij duke thënë se “që të ruheni”. Fjala arabe **ءاقبات** do të thotë për t'u mbrojtur, për t'u fortifikuar dhe për t'u triumfuar. Pra, agjërimi synon që besimtari t'i nënshtrohet mbrojtjes së Zotit, të fitojë mirësi dhe dobi, ndërsa ruhet nga e keqja. Agjërimi gjithashtu shërben si një mjet për pranimin e lutjeve. Njeriu duke duruar urinë dhe etjen, vetëdijësohet e ndërgjegjësohet ndaj vuajtjes dhe mjerimit të njerëzve të tjerë. Ai duke

ndier vuajtje, bëhet më i gatshëm për të ndihmuar të tjerët. Ramazani e ushqen me frymën vetëmohuese dhe altruiste. Kjo gjë shërben jo vetëm për të zgjidhur problemet e shoqërisë, madje e brumos popullin me virtytin e sakrificës. Agjërimi i mëson njeriut durim e vetëpërmbytje, me qëllim që ai t'u bëjë ballë trimërisht vështirësive dhe sprovave të jetës dhe të mos dorëzohet kurrë para tyre. Ramazani i mundëson njeriut aftësi për të kapërcyer çdo mundim në adhurimin e Zotit si dhe në obligimet e tjera fetare.

Njeriu, kur gjatë agjërimin, u shmanget veprimeve të kota, atij i gjallërohen vetitë shpirtërore. Duke mprehur shikimin e tij shpirtëror, ai reflekton më thellë mbi sjelljen dhe të metat e tij, dhe mundohet t'i zëvendësojë ato me cilësi të larta. I

Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

الصَّيَّامُ جُنَّةٌ وَهُوَ حَصْنٌ مِنْ حُصُونِ الْمُؤْمِنِ،
وَكُلُّ عَمَلٍ لَصَاحِبِهِ إِلَّا الصِّيَامَ -
يقول الله: الصيام لي وأنا أجزى به

“Agjërimi është mburojë dhe një fortesë për besimtarin. Çdo vepër e njeriut i përket atij. Allahu thotë: Agjërimi është për Mua dhe Unë jam shpërblimi i tij”.¹ Agjërimi i jep njeriut mësimin e qëndrueshmërisë dhe këmbënguljes në sjelljen e tij. Kur besimtari kalon tridhjetë ditë të Ramazanit, duke u përpjekur të heqë dorë nga veset e tij, duke u zgjuar herët për të adhuruar Zotin, duke studiuar Kuranin Famëlartë, kohën e lirë e kalon në përmendjen e Zotit dhe në meditim, nëse në një anë u shmanget punëve të padobishme, në anën tjetër angazhohet në vepra fisnike dhe bamirëse, pra kur del nga muaji Ramazan, ai tashmë është një ushtar i kalitur, i pajisur me virtyte të larta, i cili shfaq vetitë më fisnike të njeriut.

Një tjetër vlerë e agjërimit është që gjatë Ramazanit besimtarët stërviten për të hequr dorë nga të drejtat e tyre të ligjshme. Nëse gjatë 11 muajve, besimtari përpiket t’u reshtet gjërave të ndaluara, në Ramazan, ai largohet edhe nga gjëra të lejuara. Shumë probleme dhe konflikte në botë, mund të zgjidhen lehtësisht nëse palët nuk do të këmbëngulin për të drejtën e tyre. Njeriu bëhet i gatshëm për t’u futur në konflikt pa menduar për pasojat tragjike, por nuk tërhiqet nga e drejta e tij. Qindra



mijëra njerëz, për të kërkuar të drejtën e tyre rrezikojnë paqen dhe stabilitetin e mbarë vendit, ndërsa po të vepronin me largpamësi, do të bëheshin faktorë të rëndësishëm në paqen kombëtare.

Pra përmes agjërimit, njeriu jo vetëm që realizon edukimin e pastrimin shpirtëror dhe lartësimin e vetëdijes së tij, ai gjithashtu fiton dobیت fizike, morale dhe shoqërore. Njeriut i zhvillohet aftësia e komunikimit me Zotin dhe i shfaqen ëndrra të vërteta. Nëse ushqimi e fuqizon organizmin trupor të njeriut, agjërimi i mpreh dhe hollon aftësitë shpirtërore të njeriut. Prandaj Allahu thotë:

وَأَنْ تَصُومُوا خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“... nëse agjëroni, është më mirë për ju, në qoftë se e dini”.²

Agjërimi ka edhe dobi fizike e shëndetësore. Trupi i njeriut duke duruar vështirësitë dhe mundimet, përforcon aftësinë e vetëpërmbytjes dhe të durimit. Madje, dobیت e agjërimit

në shëndetin e njeriut nga mosngrënia e ushqimit janë botërisht të pranuar. Sipas mjekëve që merren me terapitë metabolike, trupi i njeriut përmban toksina mjedisore si dhe disa substanca të tjera të dëmshme, që mund të hiqen duke agjëruar apo duke detoksifikuar trupin. Sipas tyre agjërimi mundëson që trupi të përqendrojë energjinë për t'u pastruar dhe për t'u shëruar vetvetiu. Agjërimi gjithashtu kontribuon edhe në sistemin e imunitetit për punë më efikase, duke lejuar më shumë oksigjen dhe rruaza të bardha në trup, që djegin më shumë dhjamë dhe si rezultat i japin trupit energji dhe përmirësojnë një sërë funksionesh shëruese. Sipas disa studiuesve, nëse personi që vuan nga kanceri agjëron, atëherë ky ndihmon në tharjen e tumorit duke shkaktuar vdekjen e qelizës. Agjërimi gjithashtu rekomandohet për ripërtëritjen e trupit, humbjen e peshës dhe për mbajtjen e peshës normale, jetëgjatësinë, kthjellimin mendor, vetëdijen dhe vetëvlerësimin. Agjërimi gjithashtu ndihmon në lënien e veseve si duhani, kafeina apo alkooli etj. Nëse njeriu agjëron në mënyrë të përmbajtur, atëherë ai ndikon dukshëm në shëndetin e tij. Pra, agjërimi është garantues për shëndetin e njeriut, ndërsa në aspektin shpirtëror ai është një burim për të fituar devotshmërinë. Agjërimi i mundëson njeriut mirësjelljen, fisnikërinë, ndershmërinë dhe edukimin brendësor. I zhvillohen

vetitë e vetëpërmbajtjes dhe guximit. Bëhet më i ndjeshëm për mjerimet dhe vështirësitë e të varfërve dhe inkurajohet që t'i ndihmojë ata. Pra, agjërimi luan një rol të rëndësishëm në kultivimin e sakrificës, vetëmohimit dhe altruizmit dhe kështu nxit shoqërinë për fshirjen e dallimeve ekonomike dhe etnike.

I Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

“Ai që nuk heq dorë nga gënjeshtria dhe veprime të rrema, Zoti nuk ka nevojë që ai të heqë dorë nga të ngrënit dhe të pirit.” [Buhariu]

Pra, nëse njeriut i mungon vullneti për të arritur qëllimin esencial, që është edukimi shpirtëror, atëherë ç'dobi mund t'i sjellë agjërimi i tij?

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ، قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: “كَيْسَ الصِّيَامُ مِنَ الْكُلِّ وَالشُّرْبِ فَقَطْ، إِنَّمَا الصِّيَامُ مِنَ اللَّغْوِ وَالرَّفَثِ، فَإِنْ سَابَقَ أَحَدٌ وَجْهَهُ عَلَيْكَ فَقُلْ: إِنِّي صَائِمٌ”

Hazret Ebu Hurejre ^{r.a.} rrëfen se i Dërguari i Allahut ^{s.a.v.s.} ka thënë:

“Agjërimi nuk është vetëm (ndalimi) nga të ngrënit dhe të pirit. Agjërimi (i vërtetë) është (shmangia) prej gjërave të padobishme dhe imorale. Nëse dikush të shan apo të provokon, atëherë thuaji: unë jam agjërueshëm”.³

1 *El-Mu'xbamul Kabir*, nr. 7608, *Sahih el-Xhami*^{us-Sujuti} nr. 3881.

2 *Kurani Famëllartë* 2:185.

3 *Mu'ata Abdullah bin Veheb*, nr. 282.

KËRKOJENI AFËRSINË E ALLAHUT


Hazret Mirza Bashirudin Mahmud Ahmad^{r.a.}
Kalifi i Dytë i Mesihut të Premtuar



Fjalim i mbajtur nga Hazret Mirza Bashirudin Mahmud Ahmad^a, Kalifi II i Mesihut të Premtuar më 18 mars 1927.

Cili është qëllimi i adhurimeve që ne bëjmë më shumë gjatë muajit të ramazanit? Përse e adhurojmë Zotin më shumë gjatë këtij muaji? Kjo është pyetja që zakonisht bën çdo njeri i mençur. Zoti i dha njeriut shëndet, fuqi, uri, stomak që tret ushqimin etj. Çfarë i ndodh që papritur ai heq dorë nga ushqimi, madje edhe nga nevojat e tij të tjera jetike dhe duke e munduar veten bën vepra të tilla me të cilat ai nuk ishte mësuar më parë. I mençuri gjithmonë mendohet para se të bëjë diçka, qoftë edhe një punë të vogël. Ai mendon paraprakisht se pse po e bëj këtë, çfarë dobie do të kem nga kjo punë? Ai nëse bën një hap, mendon se pse po e bëj këtë. Ai nëse ngre dorë, mendon se pse duhet ta ngre dorën. Prandaj është e domosdoshme që edhe ata që agjërojnë të mendojnë për qëllimin e agjërimit. Nëse ata nuk e dinë qëllimin dhe prapë agjërojnë, atëherë puna e tyre është fëmijërore. Pavarësisht se njeriu mund të jetë i rritur, në këtë rast, punët i bën në mënyrë fëmijërore. Sepse fëmijët i bëjnë punët pamenduar.

Gjatë ramazanit, njeriu agjëron nga dhjetë deri në katërmëdhjetë orë, madje në vendin tonë (Indi) nga dymbëdhjetë deri në gjashtëmbëdhjetë orë. Gjatë gjithë kësaj kohe, ai as ha e as pi. Por nëse nuk e di se pse nuk ha e pse nuk pi,



atëherë ai u ngjan atyre fëmijëve, të cilët duke parë të mëdhenjtë ngulin këmbë që të agjërojnë. Ata nuk e kuptojnë se cila është dobia e agjërimit, pasi ata nuk mendojnë për këtë. Por, meqë muaji i ramazanit i tërheq, ata insistojnë për të agjëruar sadopak ditë. Pra, fëmijët të cilët kur ndiejnë uri, nuk rrinë dot asnjë minutë pa ngrënë diçka, edhe ata insistojnë të agjërojnë për dymbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë orë. Kjo tregon se agjërimi ka një tërheqje për shkak të së cilës dhe duke i parë më të rriturit, me dëshirë pranojnë të vënë veten në mundim. Atëherë, a mos vallë agjërimet tona janë si agjërimet e këtyre fëmijëve të cilët agjërojnë vetëm sepse prindërit e tyre agjërojnë dhe përtej kësaj nuk e vrasin mendjen?! Ashtu si fëmijët edhe ne nuk po mendojmë rreth dobive të

agjërimit. ...Nëse kështu është puna, atëherë ne sado të mëdhenj të jemi në moshë, mbetemi ende fëmijë. Një plak gjashtëdhjetëvjeçar nëse agjëron, e nuk e kupton dhe nuk e ndien dobinë e agjërimit, atëherë ai pavarësisht se është në këtë moshë, puna e tij është vërtet fëmijërore. Ai nuk mund të quhet i mençur. Madje sipas meje, ai është më i pamend se sa një fëmijë. Sepse fëmija sheh një tërheqje dhe një bukuri në ramazan, të cilën ai nuk shpreh dot me fjalë dhe prandaj insiston të agjërojë. Por plaku agjëron sepse e ka zakon. Edhe ai filloi të agjëronte duke parë prindërit e tij që agjëronin. Por tani kur prindërit e tij kanë ndërruar jetë, ai vazhdon të agjërojë duke ndjekur një traditë dhe pastaj duke e bërë si zakon. Ai as bukurinë e agjërimit nuk e sheh dot.

Por, njeriu me mend është ai që përsiatet para çdo pune. Ai mendon se çfarë dobie dhe çfarë humbje do të kem po ta bëj këtë punë? Nëse ai do të agjërojë gjatë gjithë muajit, nuk ha as nuk pi, mundohet të mbajë në kontroll epshet dhe dëshirat e tij, dhe prapë nuk mendon se pse po bën këtë punë, atëherë si mund të quhet i mençur ai? Dobia e agjërimit që është përmendur në Kuranin Famëlartë, është se agjëruesi i afrohet Zotit. Unë ju pyes të gjithëve ju, a me të vërtetë jeni afruar te Zoti këto ditë dhe a ju është afruar Zoti juve? A me të vërtetë ka ndonjë ndryshim midis lutjeve tuaja që bënit përpara

dhe lutjeve që bëni këto ditë? A me të vërtetë keni vërejtur një ndryshim në vetveten tuaj që nuk ka qenë më parë? A me të vërtetë adhurimet tuaja kanë përparuar gjatë këtyre ditëve? A keni fituar me të vërtetë më shumë njohjen e Zotit gjatë këtyre ditëve? Nëse përgjigjja është jo, atëherë çfarë dobie keni fituar nga agjërimet tuaja?! Nëse kjo është e vërtetë se agjërimi është mjet për t'iu afruar Zotit, atëherë më thoni se sa shumë jeni afruar pranë Tij? Më tregoni shenjat e atij afrimi që keni fituar gjatë këtyre ditëve!

Nëse zemrat tuaja ende janë ashtu të ndryshkura, siç kanë qenë përpara, nëse ju ende e keni atë mërzi, e cila ju largon nga Zoti, nëse akoma nuk keni filluar të gjeni kënaqësi në adhurim e në ibadet, nëse ende nuk keni gjetur shijen e pranimit të lutjes dhe nëse dora e mëshirës së Zotit nuk ju kap siç e kap një nënë e mëshirshme fëmijën e saj, atëherë duhet të mendoni dhe të më tregoni se çfarë dobie ju kanë sjellë agjërimet? Një gjë që sot nuk ju bën dobi, si mund t'ju bëjë dobi në ditën e kiametit kur do të kenë kaluar qindra vjet! Ju nuk mund të thoni se disa gjëra ju sjellin dobi me vonesë dhe se edhe agjërimi është një prej tyre. Jo! Sepse agjërimi nuk është një gjë e tillë që të sjell dobi me vonesë. Allahu i Madhërishëm thotë: Kur robërit e Mi agjërojnë dhe pyesin rreth meje, atëherë Unë u them “In-ni kerib” “O rob i im

Unë jam shumë afër. Unë kam ardhur te ti.” Prandaj edhe nëse do të supozojmë për pak kohë që disa adhurime na bëjnë dobi vetëm në ditën e gjykimit, prapë se prapë agjërimi nuk bën pjesë në ato gjëra. Dobia e agjërimit është e shpejtë dhe e sigurt. Nëse nuk e ndieni këtë, atëherë ju nuk keni fituar as edhe një milimetër nga afrimi i Zotit.

Unë shoh që disa prej jush janë dhënë pas gjërave të tjera. Mendimet e tyre janë larguar në punë të tjera. Aftësitë e tyre po harxhohen në çështje të tjera dhe nuk merakosen aspak për të gjetur afrimin e Zotit. Ata duhet të zgjohen për të bërë atë punë për të cilën i ka krijuar Zoti. Ata shpenzojnë dhe harxhojnë aftësitë, pasurinë, kohën dhe çdo gjë të tyre për gjëra të kota. Ata nuk mundohen e nuk e vrasin mendjen për të gjetur afrimin e Zotit. Hapi i tyre është në një drejtim krejtësisht të kundërt. Ata nuk fitojnë asgjë nga përlësia. A mundet, ai që ecën drejt shejtanit t’i afrohet Zotit? Ai që hidhet në zjarr si mund të shijojë kënaqësinë e ujit? Ai që jeton në errësirë, si mund të ndiejë kënaqësinë e dritës. Ky helm që është bërë pjesë e jetës suaj, nuk mund të largohet kurrësi, derisa të mos i vini buzët tuaja në kupën e ilaçit që do t’ju shërojë, të cilin e ka përcaktuar Zoti. Derisa të mos pini ndonjë gllënjë nga kupa e shërimit, adhurimet tuaja nuk do t’ju sjellin dobi. Falni namazet, falini për vite me radhë, për vite vazhdoni të agjëroni, bëni haxh dhe bëjeni për

shumë vite, por nëse nuk e shijoni atë kupën e shërimit, nuk do t’ju bëjnë dobi as namazet, as agjërimet, as haxhet e as adhurimet e tjera.

A nuk është e vërtetë që miliona muslimanë kanë hequr dorë tashmë nga namazi? Sepse ata thonë se ky është vetëm një ushtrim që çdo ditë njerëzit e bëjnë kot më kot. Ata thonë se “Pse po bën një punë të kotë që nuk të afron te Zoti? Thuhet për namazin se ai na afron te Zoti, por ai nuk na afroi. Atëherë kjo punë është e pavlerë. Prandaj ne i braktisim këto ushtrime të kota!”

A e dini se pse ndodh kjo? Pyetini zemrat tuaja! A nuk ndodh kjo sepse namazi nuk falet ashtu siç duhet? A nuk ndodhi kjo sepse ata nuk janë përpjekur për të gjetur qëllimin e namazit. E njëjta situatë është me agjërimin. Shumë njerëz kanë hequr dorë edhe nga agjërimi duke gjykuar se ai nuk po i afron te Zoti. Ndërsa e vërteta është se ata nuk janë përpjekur për ta gjetur dobinë dhe qëllimin e tij. Ata nuk e kanë kuptuar fare se për se ka qenë agjërimi. Namazi, agjërimi apo adhurimet e tjera nuk kanë mangësi. Ato me të vërtetë na mundësojnë afrinë e Zotit. Nëse ka mangësi dikush, atëherë ai është njeriu, pasi nuk ndjek rrugën e duhur. Rrjedhimisht këto lloje njerëzish e humbin besimin dhe kur nuk kanë besim, atëherë si mund t’i praktikojnë këto adhurime. Kështu janë larguar



njerëzit nga namazet, agjërimet etj. Hazret Mesihu i Premtuara.s. thoshte ... çudi, ai që dëshiron t'i afrohet Zotit por nuk e arrin suksesin, ai nuk e quan të gabuar mënyrën e tij, por heq dorë nga të gjitha përpjekjet duke dështuar plotësisht. Këta njerëz e adhurojnë Zotin në mënyrë të gabuar dhe kur nuk e gjejnë, thonë se Zoti nuk gjendet. Nëse ata do ta kontrollonin veten e tyre për ta përmirësuar atë, atëherë patjetër që do të kishin rezultat. Por ata nuk veprojnë kështu.

A është e mundur që një njeri të ecë në rrugën e duhur dhe prapë të mos arrijë në destinacion? Shikoni, nëse një njeri nis nga këtu për në Batala (një qytezë afër Kadianit) dhe të kalojnë orë pas ore, ditë pas dite, javë pas jave, muaj pas muaji madje vit pas viti, atëherë a prapë do të mendojë ai se është në rrugën e drejtë? Mos të flasim për ditët, javët, muajt apo vitet, nëse ai nuk shikon qytezën e Batalasë vetëm pas tre katër orësh, atëherë ai do të kuptojë menjëherë se i ka rënë një rrugë të gabuar. Në të

njëjtën mënyrë, një njeri nëse nuk e gjen afrimin e Allahut edhe pse e adhuron, atëherë, edhe ai duhet ta kuptojë se ka diçka të mangët në adhurimin e tij dhe ai nuk ka të drejtë të ankohet nëse do të vazhdojë një rrugë të gabuar, se pse nuk e gjen Zotin. Pra, Ai Zot që thotë se “Unë jam afër”, Ai patjetër që është afër, por për ta gjetur Atë, adhurimet tuaja duhet të jenë të drejta. Ai që nuk e kupton këtë realitet, atëherë dijeni mirë se pulsi i tij ka vdekur dhe ai duhet të vrasë mendjen për gjallërimin e tij. Ai është i verbër që nuk e sheh rrugën, por ecën me hamendje. Ai ecën si kau gjatë shtrydhjes së vajit i cili nuk arrin dot një vend të ri. Njeriu i tillë duhet të shqetësohet për përmirësimin e tij. Prandaj, kontrollojeni vetveten tuaj! Shikoni mirë brendinë tuaj dhe llogarisni vetë çfarë adhurimesh bëni. Rregullojeni veprat tuaja, rregullojeni mendjen dhe dijen tuaj, sepse Zoti thotë jam afër dhe Ai me të vërtetë i afrohet njeriut, por nëse juve nuk ju afrohet atëherë fajin e keni ju. Largojeni atë të metë dhe pastaj do të shikoni se si do të ju afrohet Zoti.

Nëse një njeri ka temperaturë me ethe dhe ndien shumë ftohtë, atëherë ai mund t’ju kërkojë edhe zjarr. Por ju sado që t’ia plotësoni kërkesën për zjarr, ai prapë nuk do të ndiej të ngrohtë. Në këtë rast çfarë do të bëni? Do t’i jepni akoma më shumë zjarr apo do ta çoni te mjeku? Sigurisht që ju do të kërkon

mjekun, sepse i sëmuri ka humbur aftësinë për të ndierë të ngrohtin. Në malarie dhe ethe të tjera, njeriu ndien shumë të ftohtë dhe kërkon të mbulohet me sa më shumë jorganë. Duke iu bindur atij, nëse ju do ta mbuloni edhe me qindra jorganë, ai prapë do të ketë të ftohtë, sepse ai ka humbur aftësinë për të ndierë të ngrohtin. Në të njëjtën mënyrë, Allahu i Madhërishëm kur thotë se Unë jam afër, por juve nuk ju duket ashtu, atëherë ju keni humbur aftësinë për të ndierë afrimin e Tij. Dhe nëse është kështu, kjo do të thotë se moralet tuaja janë të sëmura, mendimet tuaja janë të sëmura, veprat tuaja janë të sëmura, dija juaj është e sëmurë, njohja juaj për Zotin është e sëmurë dhe juve ju duhet një mjek shpirtëror.

Prandaj, bëjini një kontroll vetes suaj! Vrisni mendjen për brendinë tuaj! Përmirësohuni para se të vijë koha kur nuk do të ketë asnjë mundësi përmirësimi, përveçse të kaloni nga zjarri i xhehenemit. Pra, përmirësohuni dhe bëhuni të aftë për t’iu afruar Zotit, përndryshe do të pendoheni në fund! Zoti na mundësoftë të gjithëve ne që të veprojmë ashtu. Amin

Përktheu në shqip: Samad Ghorri

(Khutbat-e-Mahmud vëll. 11, f. 56-62)
<http://www.alislam.org/urdu/khm/KM11-9.pdf>

LAJME NGA XHEMATI

Bekim Bici

Delegacioni nga Shqipëria merr pjesë në Xhelsa Salanën e Bosnjës



Në vazhdim të ndërtimit të marrëdhënieve të mira dhe bashkimit në vëllazëri brenda Xhemit Musliman Ahmedia, muaji gusht shënoi një tjetër hap. Një delegacion nga Shqipëria mori pjesë në tubimin vjetor të Bosnjës, në qytetin e Sarajevës. Përveç temave të mbajtura nga xhemati vendas, fjala iu dha edhe



zotëri Bujar Ramajt, si anëtar i xhemit të Shqipërisë. Në fjalën e tij z. Ramaj, tregoi udhëtimin e tij shpirtëror deri në pranimin e Mesihut të Premtuar ^{a.s.} si dhe falënderoi xhematin vendas për mikpritjen e bërë.

Muslimanët për lirinë, paqen dhe besnikërinë



Muslimanët për lirinë paqen dhe besnikërinë, është kryetitulli i fletëpalosjeve të shpërndara nga anëtarët e Xhemit Musliman Ahmedia të Shqipërisë dhe Kosovës, në dy vendet



tona. Pas përpjekjeve të pareshtura për të njolllosur Islamin me terrorizmin, Xhemati Musliman Ahmedia, nën udhëheqjen e Kalifit të Pestë të Islamit, Hazret Mirza Masrur Ahmedit, ka marrë nismën që të përhapë mesazhin e paqes në të gjitha anët e globit. Në këtë iniciativë u përfshi edhe Shqipëria e Kosova, ku u shpërndanë disa mijëra kopje të këtij mesazhi.

Mbahet Xhelsa Salana e 8-të e Shqipërisë



E diela e 18 tetorit 2015, shënoi mbajtjen e Xhelsa Salanës së 8-të të Shqipërisë e cila çeli siparin e saj me ngritjen e flamurit të Islam Ahmediatit dhe vendit organizator. Menjëherë pas ngritjes së flamujve tubimi u hap nga recitimi i Kuranit Famëlartë ashtu siç e do edhe Islami. Kjo konferencë fetare vjetore, themeluar nga Mesihu i Premtuar^{a.s.}, këtë herë pati në fokus të vet këto tema:



- *Zoti është i Gjallë nga Nezir Balaj*
- *Revolucion i sjellë nga Mesihu i Premtuar.s. nga Shabid Ahmed*
- *Kurani Famëlartë udhëzim për mbarë njerëzimin nga Valdon Mustafa*
- *Jeta e Profetit Muhameds.a.v.s. në aspektin e drejtësisë nga Javaid Iqbal Nasir*
- *Bindja ndaj Kalifatit të vërtetë nga Samad Ahmed*
- *Zoti ka skalitur dashurinë në zemrën e besimtarit nga Bujar Ramaj*
- *Islami dhe liria e shprehjes nga Rexhep Hasani*
- *Si mund të parandalohet radikalizmi fetar? nga Muhammed Zakaria Khan*





Kjo konferencë pati mysafirë nga Maqedonia e Kosova, të cilët përfituan nga bekimet e Xhelsës. Një natë më parë u zhvillua edhe një takim me ligjërues Muhammed Zakaria Khanin, ku të pranishmit ishin të lirë të bënin pyetje rreth Islamit apo paqartësive në lidhje me Xhematin.

Zhvillohet seminari, “Roli i internetit në përhapjen e mesazhit të Islam-Ahmediatit”



Është zhvilluar më 6 mars 2016 seminari i parë nga Xhemati Musliman Ahmediame temë: “Roli i internetit në përhapjen e mesazhit të Islam Ahmediatit”. Ky seminar u mbajt në Kukës, ku pjesëmarrës kishte

nga Shqipëria dhe Kosova.

Ligjëruesi Samad Ahmed Ghorri, duke cituar profecinë e Kuranit, “Është Ai që dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, që ta bëjë atë të triumfojë mbi të gjitha fetë, edhe pse mohuesit nuk e pëlqejnë këtë”. (Kurani Famëlartë 61:10), tha se, ky ajet nga shumë prej dijetarëve të Islamit pranohet se i dedikohet kohës së Imam Mehdiut a.s dhe është



paralajmërimi për triumfin e së vërtetës. Teknologjia është një dhuratë e çmuar, e cila edhe pse e shpikur në rastet më të shumta nga shkencëtarët jomuslimanë, ne duhet të dimë se si ta përdorim atë në funksion të së vërtetës. Është dhuratë për Xhematin e Imam Mehdiut. Kjo u mbështet edhe nga një këshillë e dhënë nga Kalifi i V i Mesihut të Premtuar a.s (Allahu e ndihmoftë fuqimisht), drejtuar ahmedianëve në fjalimin e xhumasë së datës 15 tetor 2010, në të cilin ai tha: “Shfrytëzoheni teknologjinë moderne për të përhapur mesazhin e Islam Ahmediatit!”.

Në këtë seminar u dhanë disa nga mënyrat se si të punohet me

teknologjinë e fundit, në përhapjen e Islam Ahmediatit, u ndanë edhe disa detyra për pjesëmarrësit, në mënyrë që e vërteta të buçasë në të gjitha trojet ku ka shqiptarë.

Xhemati Musliman Ahmedia pranë 35 familjeve në nevojë



Xhemati Musliman Ahmedia më 18 shkurt 2016 mori një nismë për t'u ardhur në ndihmë 35 familjeve në nevojë, në fshatin Rrubjekë të Maminasit. Në këtë aktivitet humanitar 35 familje morën secila nga një paketë ndihme, në të cilën gjendeshin ushqimet bazë. Familjet shprehën mirënjohjen dhe falënderimet e tyre, ku ndër të tjera thanë, se fushata të tilla nuk janë ndërmarrë nga askush në atë zonë përveç këtij rasti.

Xhemati Musliman Ahmedia ka



zhvilluar këtë aktivitet humanitar, në vazhden e shumë aktiviteteve të ngjashme, në Tiranë, Fier, Novoselë të Vlorës, Kashar, Berat etj.

Kjo bashkësi bën thirrje që çdokush që e ka të ndezur humanizmin në brendësinë e tij, të ndihmojë ato që i ka pranë dhe që janë në nevojë. Të dhënit nuk varfëron askënd, përkundrazi kthen shpresën, buzëqeshjen dhe mbush librin me të cilin çdokush do të dalë para Zotit.

Bashkimi kombëtar ndodh nga të rinjtë e xhematit të Shqipërisë e Kosovës



28-29 nëntori i 2015-ës shënoi programin e radhës në respekt të këtyre datave, midis Mexhdis Khudamul Ahmedia (Organizata e të rinjve të xhematit) të Shqipërisë dhe Kosovës, aktivitete këto që tregojnë bashkimin



kombëtar me vepra e jo fjalë. Aktiviteti filloi me një bisedë të përbashkët midis anëtarëve të xhematit mbi konceptin e vulës së profetizmit dhe rreth botëkuptimit të tij drejtë. Aktiviteti vazhdoi me disa miqësore futbollit, e cila u fitua nga të rinjtë e Pejës. Gjatë ditëve të qëndrimit në Kosovë, mbizotëronte hareja dhe fryma e vëllazëridashurisë dhe bashkimit në mirësi.

Aktivitet i përbashkët Kosovë-Shqipëri, në Brezovicë



Në vazhdë të aktiviteteve të përbashkëta Kosovë-Shqipëri, u zhvillua edhe takimi i radhës më 12 e 13 mars 2015. Takimi u bë në Prishtinë, ku pas faljes së akshamit, u mbajt një ligjëratë mbi temën “Vëllazëria në Islam” nga Valdona Mustafa. Të nesërmen të rinjtë e dy



xhemateve u bashkuan për një piknik në Brezovicë. Udhëtime të tilla bëhen me qëllim për të gjetur kënaqësinë e Allahut dhe për të rritur dashurinë midis anëtarëve. Profeti thotë se, engjëjt garojnë në shënimin e emrave të atyre personave që marrin pjesë në kuvende ku përmendet emri i Allahut.



Zhvillohet Ixhtimaja e katërt Shqipëri-Kosovë

Ashtu si çdo vit edhe sivjet Mexhlisi Khudamul Ahmedia i Shqipërisë dhe

Kosovës, mbajtën ixhtimanë e katërt. Në këtë eveniment përfshiheshin gara të ndryshme akademike si: recitimi i Kuranit, mbajtja e fjalimeve, mësimi i namazit përmendësh, vëzhgimi dhe kumtimi, kumtimi i mesazhit dhe kuici me pyetje nga Islami, Kurani, Ahmediati dhe aktualiteti. Ndër garat sportive u

tërheqje litari, pingpong, sprint rezistues dhe stafetë. Në këtë vit garat për fëmijë ishin një çlodhje dhe arritje ku fëmijët pjesëmarrës ishin shumë të përgatitur si në garat akademike ashtu edhe në lojërat zbavitëse. Kësaj ixhtimaje iu bashkuan mysafirë edhe nga xhemati i Zvicrës.



zhvilluan, ndeshje futbollit, volejbollit,

Dashuri për të gjithë, urrejtje për askënd 67

Nga shtypi

MUSLIMANËT MIRËPRESIN PERSONIN, I CILI QËLLOI MBI XHAMINË E TYRE



“Ky është një moment i rrallë, kur shikoni dikë që ka aq shumë urrejtje ndaj jush dhe që vjen e ju kërkon falje”

Të shtunën e kaluar, Ted Hakey, ish-marinar, u përkul në namaz, me ballë përtokë, bashkë me fqinjët e tij muslimanë brenda xhamisë në Connecticut.

Përmasat e këtij gjesti i lanë përshtypje çdokujt.

Vetëm para disa muajve, në natën e sulmeve terroriste në Paris, Hakey kishte shkuar në klubin lokal dhe kishte kthyer dhjetë kriklla. Në orët e para të mëngjesit, ai u kthye në shtëpi, piu prapë, dhe mbushi shotganin dhe pistoletën e tij 9mm. Pastaj, shkoi në oborr dhe zbrazti karikatorin në drejtim të xhamisë përbri shtëpisë së tij.

Faqja e tij e Facebook-ut ishte mbushur me komente të ndyra dhe shprehjet urrejtëse anti-muslimane. Mesazhet që ai u kishte dërguar shokëve të tij, të zbuluara nga hetuesit, tregonin të njëjtën gjë.

Në një postim, ai kishte treguar se jeton ngjitur me një xhami që e mban nën vëzhgim përmes dylbisë së tij. Në një postim, ai shkroi: “Is Muslim season open yet? I’m in a target rich environment.” (A është hapur akoma stina muslimane? Unë jam në një mjedis të pasur me objektiva.)

Por në vend që t’i përgjigjej me urrejtje,

dr. Mohammed Kureshi, president i xhamisë “Bejtul Aman” (Shtëpia e paqes), mendoi se ai mund të ishte një fqinj i mirë, dhe bëri një përpjekje për ta njohur nga afër Z. Hakey dhe bashkëshorten e tij. Ai arsyetoi se ndoshta në këtë mënyrë, Z. Hakey-it do t’i kalonte mëria dhe indinjata.

Kështu që, pesë muaj pas gjetjes së fishekëve të Z. Hakey brenda sallës së faljes, dr. Kureshi e ftoi në një event në xhami me titullin “Islami i vërtetë dhe ekstremistët”. Kur çifti Hakey mbërriti, të gjithë pjesëmarrësit i mirëpritën pa asnjë paragjykim. Z. Hakey i përlotur u kërkoi falje për shqetësimin që u kishte shkaktuar.

Z. Hakey kishte pyetur avokatin e tij për mundësinë e faljes, prandaj dr. Kureshi bashkë me disa të tjerë e takuan atë privatisht para një jave në të Premten e Madhe të Pashkëve. Dr. Kureshi, para se të dëgjonte kërkesën për falje nga Z. Hakey, i dhuroi atij vezët çokollatë të Pashkëve.

“Unë kurrë nuk kam pasur një takim të tillë”, u shpreh dr. Kureshi për takimin e parë.

“Ishte mjaft emocional. Ai ishte i përlotur dhe dridhej i tëri. Unë mund të shikoja në sytë dhe në zemrën e tij, se çdo gjë që thoshte ai, ishte e sinqertë. Unë po ndieja se gjithçka buronte nga shpirti i tij. Është një çast i rrallë, kur shikoni dikë që ka aq shumë urrejtje ndaj jush, vjen dhe ju kërkon falje”.



Megjithatë, disa besimtarë ishin akoma të kujdesshëm duke ditur se personi në fjalë u kishte shkaktuar dëm. Dr. Kureshi e ftoi Z. Hakey për të vizituar xhaminë, me qëllim që ai t'u kërkonte falje të gjithë besimtarëve.

“Si një fqinj, unë kisha frikë. Por kemi gjithmonë frikë kur nuk dimë diçka. Jeni gjithmonë i frikësuar nga e panjohura”, u shpreh z. Hakey në eventin që u zhvillua më 2 prill, shkroi gazeta The Hartford Courant.

“Duke hedhur hapa përpara, unë dua ta shkrij këtë distancë, dhe dëshiroj të ndihmoj edhe dikë tjetër që të mos bëjë të njëjtin gabim që bëra unë”.

Z. Hakey, në një intervistë, u shpreh se “ishte shumë i emocionuar” dhe u prit me aq shumë dashuri dhe zemërgjerësi, pas gjithë asaj që kishte bërë. Ai gjithashtu tha se po merr mesazhe falënderimi nga

muslimanët nga e gjithë bota për gjestin e tij që kërkoi falje.

“Ajo falje ishte aq shumë e singertë. Kam kuptuar se me të vërtetë ata janë njerëz të mirë, dhe mënyra sesi ata e menaxhuan këtë, ishte mbresëlënëse” u shpreh ai.

Bashkëshortja e tij, Znj. Myra e cila gjithashtu e kishte shoqëruar, shtoi se ishte mahnitur nga dhembshuria e tyre dhe ngrohtësia e mirëpritjes. Ajo shtoi se edhe pse nuk i ka mbështetur qëndrimet e bashkëshortit të saj kundër muslimanëve, përsëri duke mos pasur njohuri (rreth Islamit) kishte ndierë frikë.

“Gratë ishin të përlotura dhe më falënderonin. Ato gjithashtu thanë se po luteshin që ne të shkonim atje... Ka aq shumë urrejtje, ndërsa këta duan vetëm paqe”.

Xhamia e dr. Kureshit i përket Xhematit Musliman Ahmedia, një bashkësi muslimane reformiste e cila beson se Mesihu ka ardhur. Themeluesi i këtij xhemati, Mirza Ghulam Ahmedi, tregoi se “Xhihadi me anë të shpatës” nuk është pjesë e Islamit, dhe tha se u duhet dhënë fund luftërave dhe gjakderdhjeve që bëhen në emër të fesë. Muslimanët Ahmedianë gjatë kësaj kohe po ndërmarrin vazhdimisht fushata sensibilizuese me parullën “Islami i vërtetë”, për të dalluar fenë nga ekstremizmi.

Kjo fushatë përmban 11 parime, të cilat nëse pranohen nga të gjithë muslimanët,

nuk do të kemi asnjë terrorizëm. Këto pika përfshijnë besimin në Xhihadin paqësor, të drejtat e njeriut dhe në parimin se “asnjë fe nuk mund të monopolizojë shpëtimin”, tha ndër të tjera dr. Kureshi.

Ky ishte mesazhi, që ai ndau me Z. Hakey, i cili premtoi se do ta shpërndajë atë tek të tjerët.

Në shkurt, Z. Hakey pranoi akuzën se kishte dëmtuar pronat fetare, një krim që konsiderohet vepër penale. Kjo çështje do të gjykohej në muajin maj, dhe ai rrezikon dënimin me burg për 14 muaj. Dr. Kureshi u shpreh se komuniteti i tij do të bëj gjithçka për uljen e dënimit.

Pas 11 shtatorit, krimet urretjese kundër muslimanëve janë rritur 10-fish, duke kapur 500 raste në 2001. Në 2014, viti i fundit për të cilin disponojmë të dhënat nga FBI-ja, u regjistruan 154 raste të tilla. Megjithatë, kjo shifër është pesë herë më shumë se para 11 shtatorit.

Sipas dr. Kureshit, ky paragjykim është rrënjësor te personat që janë të painformuar, madje sipas sondazhit të kryer nga Pew Research në 2015, më shumë se 60% e amerikanëve janë shprehur se nuk kanë asnjë kontakt personal me muslimanët.

Dr. Kureshi u shpreh se ai është shumë i ngazëllyer nga kjo miqësi e re me Z. Hakey, dhe shpreson se ky ish-antagonist mund të bëhet një zë i fuqishëm për t’u ballafaquar me qëndrimet negative kundër Islamit.

“Ishte shumë emocionuese ta shikoje

atë” tha dr. Kureshi. “Imagjino, vetëm para disa muajve ai ishte armiku ynë. Ju duhet ta mendoni nga këndvështrimi i tij. Ai duhet të ketë shumë guxim të qëndrojë mes atyre personave, të cilët ai i kishte urreyer më parë. Unë besoj se ai ka pasur një ndryshim në zemër”.

Z. Hakey – i cili ia atribuon këtë ndryshim edhe programit të trajtimit kundër alkoolizmit, që përmban meditim dhe kopshtari, që të gjejë kthjelltësi shpirtërore – tha se ai tashmë ka filluar t’u kundërpërgjigjej postimeve urryese në Facebook.

“Ju lutem, më dëgjoni, ju jeni plotësisht i gabuar në këtë pikë”, ai komentoi, kur shikoi se dikush po kritikonte muslimanët. Kur ata i kundërvihen, ai shkuran: “Unë kam qëlluar me armë në xhami, prandaj mos më trego mua. Ti duhet të mësosh dhe të edukohesh”.

“Çdo ditë ti bombardohesh me imazhet negative dhe postimet që citojnë keq Kuranin... Po bëhet mjaft katrahurë, që gjithnjë po e mjegullon dallimin midis terroristëve dhe muslimanëve në përgjithësi”, tha Z. Hakey.

“Në këtë aspekt, ai ishte i keqinformuar, dhe ishte pikërisht kjo situatë që e nxiti për të vepruar në këtë mënyrë. Por, kur ia prezantova besimin tim, ishte diçka që i bëri shumë përshtypje”, përfundoi dr. Kureshi.

Autor: Colby Itkowitz

U botua në gazetën “The Independent”, më 7 prill 2016.

Copyright The Washington Post

Index in English

Eidul-Fitr - Editorial (Samad Ghori)	4
Prayer for breaking the Fast	6
The connection of Ramadan with the Holy Quran (Hazrat Muslih Maud, Khalifatul Masih II r.a.)	8
Medical benefits of Fasting (Amtul Q Farhat)	14
Fasting – A Pillar of Islam (Muhammad Ashraf Zia)	16
A Prayer of the Holy Prophet s.a. for unity, peace and positive values	31
Ramadan – Seven benefits of Fasting (Atif Rashid)	32
Prayer for the one who cannot fast (The Promised Messiah a.s.)	37
Good and Evil (Friday Sermon of Hazrat Khalifatul Masih V (a.b.a.) delivered on 11-03-2016)	38
The purpose of Fasting (Shahid Ahmad)	52
Seek nearness of Allah (Friday Sermon of Hazrat Khalifatul Masih II (r.a.) delivered on 18-03-1927)	56
News (Bekim Bici)	62
Muslims welcome a man who shot at their mosque in Connecticut	68